

Në udhëkryqet e jetës

Histori emigrimi

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen"
Tiranë 2004


Idea për realizimin e këtij libri dhe financimi i tij është bërë nga:
Die Realisierung dieses Buches entstand dank der Hilfeleistung von:

Patrice de Mestral

Redaktore Irena Dono
Übersetzung Suela Jorgaqi
Design & Layout Elsi Kongo
Shtypi\Druck “Gent Graphic”

© Shoqata “Shpresë për të Ardhmen”
“Der Verein” Hoffung für die Zukunft”
Bulevardi “Gjergj Fishta“, Kulla 8, Ap. 11, Tirana-Albanien
Tel./Fax.: + 355 4 224 033
E-mail: kape@albaniaonline.net

Aktiviteti i Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”







E thënë shkurt

Kjo përmbledhje modeste me rrëfime dramatike është përgatitur nga stafi i projektit “Kape të Ardhmen”. Ky është një projekt i Shoqatës social-humanitare shqiptare “Shpresë për të Ardhmen”, e cila është themeluar në 1999.

Shoqata ka si qëllim kryesor të ndihmojë në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të të rinjve të riatdhesuar nga Zvicra dhe nga vende të tjera evropiane.

Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” me programin e saj ofron:

- Mundësi për të fituar një profesion pranë punishteve të vogla të biznesit për një periudhë nëntëmujore
- Mbështetje financiare për kurse trajnimi
- Këshillim për probleme sociale dhe familjare
- Promovon integrimin social përmes takimeve të quajtuara “Shtëpia e Hapur”
- Organizon aktivitete në shkolla për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve ndaj rrezikut të migrimit të paligjshëm.



Në vend të parathënies

Përsëritet pothuaj i njëjti ritual: njerëz të dëshpëruar, që duket se nuk kanë çfarë humbin, nisen drejt botës së qytetëruar. Ata nisen me shpresën se dikush i pret matanë kufirit, se atë që nuk e bëri shteti i tyre, do ta bëjë një shtet tjetër që do t'i presë pa mëdyshje, me krahëhapur dhe do të kujdeset për ta. Por gjithçka që ata përjetojnë është një kalvar i gjatë mundimesh, një rropatje për ta vendosur veten në një realitet kryekëput të pangjashëm me atë të jetuar e provuar deri në çastin e ikjes dramatike.

Lexuesi do ta verë re që në krye se historitë i ngjajnë aq shumë njëra-tjetrës, të rinjtë shqiptarë i shtyjnë të njëjtat motive të rrahin rrugët e shpresës së madhe në kërkim të një jete më të mirë, të një pune që do t'u sillte ca të ardhura për të ndihmuar familjet e tyre në Shqipëri.

Por megjithëse janë pothuajse të ngjashme si kronologji ngjarjesh, prapëseprapë secila histori ka përjetime me ngjyresë të veçantë, ka pasazhe të bukura që shprehin një gjendje emocionale në përshtatje të plotë me rrethanat, me njerëzit, të cilët nuk shfaqen si personazhe konkretë, por paraqesin një kategori të caktuar njerëzish p.sh. skafistët, shoqëruesit, policët e huaj, deri edhe njerëz të thjeshtë me të cilët protagonistët e këtyre ngjarjeve kanë kontaktuar.



Padryshim këto tregime janë dëshmi autentike që të rrëqethin, edhe pse janë shkruar nga të rinj që ndoshta i kanë derdhur për herë të parë në letër ato që kanë përjetuar. Shpesh kam menduar se, ndonëse, nuk e kanë forcën e duhur artistike, këto histori janë më dramatike, aventurat më të mëdha, ato të emocionojnë po aq dhe të trishtojnë po aq. Nganjëherë gjen në to përkufizime aq të bukura, saqë befasohesh me saktësinë dhe thellësinë e mendimit të tyre.

Pa mëdyshje mund të them se këto copëza historish, fatesh njerëzore që përpëliten përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë së vendit tonë gjatë këtij trembëdhjetëvjeçari tranzicioni të gjatë e të mundimshëm dhe shprehin dëshirën e pashuar të shqiptarëve për t'u integruar në familjen e madhe evropiane si një komb i barabartë me të tjerët.

Stafi i Projektit “Kape të Ardhmen” ka bërë një punë vërtet të lavdërueshme dhe këmbëngulëse për t'i nxitur të rinjtë e ndihmuar nga programi i riintegritimit të të rinjve të riatdhesuar nga Zvicra të shkruajnë historitë e tyre të migrimit shpesh të pafat. Shpresojmë që lexuesi ta mirëpresë nismën tonë për t'i botuar ato.

Irena Dono
Drejtoresh e Ekzekutive



Shumë mund për të shkuar, fare lehtë për t'u kthyer

Një ditë u takova me një shok të vjetër që kisha shumë vitë pa e parë. U çudita sa shumë kishte ndryshuar ai njeri, fliste me arrogancë dhe mendjemadhësi, duke futur në bisedë herë pas here edhe fjalë të huaja. Nuk ia vura veshin shumë, por megjithatë më joshi ideja për të shkuar bashkë me të në një vend të bukur që quhej Zvicër. Ka qenë gjithmonë ëndrra ime. I thashë “po” ftesës së tij të bujshme, sidomos kur mësova se shpenzimet do t'i merrte përsipër bos i G. që ishte në Itali.

Shkuam në Vlorë në shtëpinë e B., të cilën e njohin mirë qindra shqiptarë e të huaj që kanë tentuar të migrojnë ilegalisht jashtë. I famshmi hotel me 25 krevate dykatësh ushtrie ku duhej të prisje derisa të nisej gomonia ishte një ish-stallë kooperative ku duhet të paguaje pesë mijë lekë natën për person. Jashtë shtëpisë nuk dilnim, se kishim frikë se na spiunonin.

Kur u nisëm, me ne erdhën edhe tre shoqërues të armatosur, të cilët na kërcënonin e shanin gjithë rrugës. Arritëm në brigjet italiane, pas një udhëtimi rraskapitës dhe ata na hodhën në ujë pa mëshirë 50 metra larg bregut. Ishim diku afër Barit, me saktësi s'e di. Unë shkova në stacionin e trenit ku më priste K. V. me makinë. Ai më çoi në shtëpinë e G. Sapo më takoi, G. më rrahu shpatullat dhe më tha: “E trim, e sheh si jeton bota! Këtu duhet guxim e shkathtësi dhe sus, pyetje s'ka”. Hëngrëm e pimë dhe në darkë u nisëm me K. Ai i njihte mirë rrugët dhe e dinte se si mund t'i shmangej policisë. Më pas na urdhëroi të hipnim fshehtas në një maune të madhe që transportonte mallra elektro-shtëpiake dhe të merrnim të gjitha rrobat e ushqimet që kishim me vete. Gjatë gjithë rrugës ndenjëm pa bërë as zhurmën më të vogël që të mos na diktonte shoferi. Atje brenda ishte errësirë e plotë. Mendoja se shpejt do të vinte çasti që do të dilja nga ajo errësirë; unë isha nisur drejt të ardhmes që rrezatonte dritë, errësira ishte vetëm e përkohshme.

Mbërritëm në Lozanë. Gjithçka ishte planifikuar deri në detaje. Zbritëm nga maunia dhe aty na priste me makinë Kujtimi, i cili zbatonte me zell urdhrat e G-së. Pas dy ditësh me njoftuan se më kishin gjetur punë te



një kosovar. Duhet të shkonim dhe të merrnim cigare te kosovari dhe më pas t'i dorëzonim në disa vende të caktuara. Mallin e mbaja unë. Klientët më linin frangat në dorë, merrnin mallin dhe largoheshin. Sa herë tentoja të pyesja se ç'ishte e gjithë kjo që më detyronin të bëja, fjala më ngrinte në buzë: "Ul kokën dhe puno që të shlyesh shpenzimet e rrugës", ishte përgjigjia shkurt. Po kthehesha në një robot që kryente pa kundërshtim dhe diskutim urdhrat e tyre.

Një ditë, teksa po bëja punën e përditshme, më ndaluan dy civilë në rrugë dhe më çuan në polici. Më kërkuan dokumentet dhe më pas më morën shenjat e gishtërinjve, emrin, fotografinë. Prej aty më çuan në një kamp në Tiçino. Dilja nëpër qytet, mundohesha të gjeja ndonjë punë apo të kontaktoja në telefon me G., por më kot, nuk lidhesha dot. Jetoja bashkë me dy afrikanë, me të cilët komunikoja me shenja. Ata ishin përdorues të rregullt droge, e merrnin me injeksion. Një ditë policia gjeti drogë në banesën ku qëndroja unë me dy afrikanët dhe kaq u desh që të më kthenin në Shqipëri.

Shumë mund për të shkuar, fare lehtë për t'u kthyer. U nisa andej për të fituar diçka, për të vënë kapital! Nuk bëra asgjë, veçse zhvlerësova veten time, duke u marrë me punë që s'më takonin. Njerëzit mbase nuk e dinë se ç'kam bërë në Zvicër, por mua nganjëherë më duket se i kam vënë vetes një njollë që nuk do të më fshihet për tërë jetën. Dhe them me vete: "Ah, sikur të isha si dikur!

A. Sina
Lushnjë



Mos vallë është shpresa ajo që na duket si drita e një fari?

Sikur të gjithë të rinjtë shqiptarë të shkruanin historitë e tyre në emigrim, nuk do të mbaronin kurrë. Një Shqipëri me kaq pak popullsi, me shtrirje gjeografike të vogël aq sa ka njerëz në botë që nuk e dinë ku bie. Një Shqipëri e vogël, por me halle të mëdha... Një Shqipëri që rënkon ditaditës nga plagët, duke shpresuar se një ditë do të ndryshojë diçka... ndoshta do të ndodhë ndonjë mrekulli...

Mos vallë është shpresa ajo që na duket si drita e një fari që ndriçon përtej brigjeve të Adriatikut? Shpresë - një fjalë prekëse, ngushëlluese, por më shumë e trishtueshme për dikë që ndoshta e ka fshirë nga kujtesa e vet. Unë them se shpresa ekziston, por deti i pesimizmit në të cilin shpesh mbytemi, nuk na lë të besojmë në shpresën. Dhe siç ndodh shpesh në jetë, rendim drejt diçkaje që nuk e dimë se si është e ndërtuar dhe çfarë mund të na sjellë, pa menduar për pasojat.

Varfëria është një nga shkaqet kryesore që shumë nga ne marrin rrugët e botës. Djem, vajza dhe njerëz të moshuar, të lodhur nga jeta nisen drejt një vendi të paftuar dhe gjejnë një sofër të pashtuar. Përse ndodh kjo me ne shqiptarët, nga nami i keq që na ka dalë? Ne shpesh nuk dimë se nga të shkojmë dhe se ç'rrugë duhet të marrim.

Kjo ndodhi edhe me mua në vitin 1998 kur u ktheva nga një vend i mallkuar, i cili më shkaktoi vetëm vuajtje për muaj të tërë. E kam fjalën për Greqinë ku e fitova me gjak bukën e gojës për vete dhe familjen që kisha lënë në Shqipëri. U ktheva nga Greqia pas 18 muajsh. Ishte shtator, kur, pa u çmallur mirë me të mitë, vendosa të shkoja me disa shokë atje ku me pak fat ndoshta do të kishim nxjerrë diçka për të fituar kohën e humbur në Greqi.

Pra, u nisëm drejt një vendi të panjohur, Zvicrës. Ditët nuk kishin mbarim teksa prisnim në Vlorë, në vendin e gomoneve që ishin i vetmi mjet lundrimi për ne. Tragetet dhe avionët ishin të rezervuar nga ata që nuk kishin hallet tona. Kisha dëgjuar për njerëz që mbyteshin teksa përpiqeshin të arratiseshin me gomone kisha humbur njeriun më të dashur të familjes në emigrim, babain, por megjithatë nuk u ktheva.



Fatmirësisht nuk u përsërit e njëjta histori me mua, edhe pse e pashë me sy vdekjen shumë herë. Ditën më pëlqente të shikoja detin e bukur, por sa i pabesë tregohej ndonjëherë natën me dallgët e tij drejt nesh. Pas shumë përpjekjesh kaluam detin dhe lamë pas tokën tonë, detin tonë. Italia ishte vendi më i bukur që kisha parë ndonjëherë. Edhe pse e pashë vetëm pak, mbeta i mahnitur dhe i vrarë në zemër duke menduar Shqipërinë e varfër.

Mbërritja në kufirin e Zvicrës, më shtangu. Vetëm 13 orë kishin kaluar nga dita e ngrohtë e verës në Shqipëri, ndërsa aty befas pashë dëborën e bardhë.

Kishte vetëm një rrugëdalje, të hynim në kamp e për të mbërritur atje duhej të kalonim nëpër mal. Më në fund u futëm në kampin e Kiasos edhe ne si shumë të tjerë. Kishte njerëz të të gjitha kombësive. Nuk e kisha ndjerë shumë lodhjen nga gëzimi, por, kur pashë trupin tim plot të nxira të shkaktuara nga gomonia, u kujtova se ç'kisha hequr. Ishte njëlloj sikur ishe zgjuar nga një ëndërr e keqe dhe asgjë nga ato që kishe parë nuk i shihje më. Kujtova se me kaq hallet mbaruan, ja, do të sistemohesha diku, do të gjeja një punë ashtu siç më kishin thënë dhe do të paguhesha mirë. Më hoqën nga kampi dhe më dërguan në Bernë, ku ishim të lirë, jo si në Kiaso që rrinim gjithë ditën të mbyllur brenda. “Ç’fat,- thosha me vete, -të jetosh në kryeqytet!” Por shumë shpejt e ndjeva se nuk ishte aq e lehtë. Planet e mia për jetën po fundoseshin në një det trishtimi.

Kisha vendosur të bëja çdo lloj pune që mund të më dilte përpara, por ishte shumë e vështirë ose as që bëhej fjalë që të gjeja një të tillë. Brodha katër muaj të tërë me shpresë se do të gjeja diçka, kur një ditë një shok më mbushi mendjen t’i futesha një pune që nuk e dija se çfarë mund të më sillte. Ndërkohë më erdhi një letër ku thuhej se duhet ta lija tokën zvicerane. Para për t’u kthyer në Shqipëri nuk kisha, kështu që u detyrova t’i futesha asaj që s’e kisha menduar kurrë, shpërndarjes së drogës. Ai që më mori në punë nuk doli ashtu siç dukej, më mashtroi. Fitimi im ishte shumë i vogël, edhe pse kisha marrë titullin “shitës”.



Ajo që i frigohesha ndodhi një mbasdite janari, kur gjithçka mori fund. U gjenda në qelinë e burgut, edhe pse nuk më dukej e vërtetë. Por ja që kështu ishte. Në vetminë e qelisë thosha shpesh me vete: A do të kishte ndodhur kjo me mua dhe bashkatdhetarët e mi sikur të ishim pajisur me dokumente të rregullta?! Unë jam i bindur se askush nga ne nuk e mori rrugën e trafikut të drogës me dëshirë. Nuk e dija sa do të dënohesha dhe çfarë do të bëhej me mua, por kaluan tre muaj dhe një ditë e lashë burgun dhe më kthyen drejt vendit tim me avion.

Pasi ndenja një vit në Shqipëri, “punëdhënësi” im erdhi më takoi dhe unë përsëri u mashtrova prej tij. Ai më thoshte vazhdimisht se këtë radhë do të ishte krejt ndryshe, po të shkoja. Kështu ai më pagoi paratë e udhëtimit dhe unë u nisa përsëri për në Zvicër. Me të mbërritur aty, duhej të punoja shumë që të laja borxhin e marrë. Por pashë se ishin po ato mashtrime të radhës së parë, kështu që vendosa të largohesha nga ai dhe shkova te disa shokë të mi të vërtetë. Ata më ndihmuan, duke më gjetur një vend për të fjetur, pasi isha pa dokumente dhe nuk dija ku të shkoja. As aty nuk zgjati shumë aventura ime dhe u gjenda në burg për herë të dytë. Ishte me të vërtetë një mallkim: dy herë në burg. Fatmirësisht më mbajtën vetëm dy muaj dhe më kthyen përsëri në vendlindje. Kisha fituar ca para, por ato i kisha borxh dhe nuk dija ç’të bëja më parë me to.

Kështu vendosa të shkoja për herë të tretë në Zvicër. Këtë herë nuk e dija se ç’më priste, por, sapo mbërrita, u mpleksa në një sherr, nga i cili përfundova direkt në spital gjysmë i vdekur dhe që andej policia më shoqëroi për në burg. E kuptova më në fund që Zvicra s’ishte për mua vetëm pas gjithë atyre gjërave që më ndodhën.

E. Niklekaj
Tropojë

Më mirë i varfër, por i lumtur

Edhe pse koha në emigrim ka qenë e gjatë, po shkruaj pak, sepse nuk dua të përshkruaj kalvarin e vuajtjeve. Kur e kam lënë bregdetin shqiptar, kam menduar se isha i lumtur. Me të arritur në shtetin që dëshiroja, pak nga pak jam ndier i huaj, pa atdhe dhe i nënçmuar. Isha pak i kënaqur ekonomikisht dhe shumë i varfër shpirtërisht. Jam kthyer në Shqipëri ku kam kuptuar dhe jam ndjerë për të dytën herë pjesë apo më qartë anëtar i familjes që kisha lënë para shumë vitesh, i varfër, por i lumtur.

Histori pa emër autori





Lotët e nënës sime

I detyruar prej kushteve të vështira ekonomike në të cilat ndodheshim (familja ime përbëhej nga 5 persona, që mbaheshin vetëm me pensionet e prindërve) si dhe për disa arsye shëndetësore, mora rrugën e emigrimit. U nisa përkundër dëshirës së prindërve që nuk donin kurrësesi që të largohesha; me para të marra hua, bleva një vizë dhe u nisa për në Itali. Kështu më përcollën rrugëve të Evropës: lotët e nënës binin parreshtur mbi mua tek më puthte dhe mjekra e babait të plakur dridhej. Fjalët e tij “mos u largo, bir” më rrihnin si çekan mbi kokë. Gjithsesi u nisa për në Itali me një shokun tim. Ishte dalja ime e parë jashtë kufijve të Shqipërisë. Në Milano u takuam me një bashkatdhetar, të cilin e pyetëm se si mund të përfitonim azil ekonomik në Zvicër. Ai më dha adresën e një mikut të tij zviceran, i cili mund të më ndihmonte për të gjetur një banesë. Së bashku me shokun shkuam në qytetin e Komos ku takuam një shqiptar tjetër që na hipi në një taksì të Zvicrës, me të cilën udhëtuam deri në qytetin e Luganos dhe prej andej shkuam me tren në Zyrìh. Nga mendja nuk më hiqej për asnjë çast momenti i ndarjes me prindërit dhe njerëzit e tjerë të shtëpisë. Isha i hutuar dhe nuk arrija të kuptoja se ku po degdisesha...

Në Zyrìh na priti zvicerani, adresën e të cilit na e dhanë në Milano. Sapo mbërritëm në shtëpinë e tij, për çudinë time, telefoi bashkatdhetari nga Milano. Ai i tha shokut tim, që kishte qenë edhe më parë në Zvicër, të shkonte në stacionin e trenit ku do të takohej me një shqiptar, i cili do t'i jepte një sasi droge. Siç mësova më vonë, këtë drogë duhej ta shisnim te klientët e bashkatdhetarit që takuam në Milano.

Nuk qëndruam më shumë se një javë në Zyrìh, duke u marrë me shpërndarje droge, pasi u kapëm nga policia. Atëherë e kuptova se ku isha futur. Mbase jo rastësisht m'u kujtuan lotët e hidhur të nënës sime të vuajtur, fjalët e babait dhe mjekra që i dridhej.

Qëndrova në burg katër muaj dhe pastaj më kthyen në shtëpi. Prisja qortimet e prindërve, por çuditërisht më pritën lotët e nënës, këtë herë të gëzuar dhe qëndrimi i heshtur i babait, ndoshta qortimi më i madh deri tani në jetën time.

E. Kasëmi
Berat

Fatkeqësisht, Evropa nuk është ajo që ëndërrohet nga të gjithë...



Në vitin 1998, ashtu si nënshtetas të tjerë shqiptarë, edhe unë u detyrova nga disa faktorë ekonomikë dhe politikë të braktisja vendlindjen, të dashurit dhe të afërmit për të kërkuar një jetë më të mirë në Evropë. Fatkeqësisht, Evropa nuk është ajo që ëndërrohet nga të gjithë. Nga rrethanat që krijohen, disa emigrantë gëzojnë të drejta dhe përfitime pozitive, disa të tjerë negative. Unë jam ai person që fatkeqësisht më kanë ndjekur rrethanat negative. Unë ndodhesha në Zvicër që nga viti '98 dhe shpresoja, ashtu si edhe shumë të tjerë, të fitoja statusin e qëndrimit tim në Zvicër, por nuk e pata fatin ta arrija këtë, se u burgosa dhe u dënova nga autoritetet zvicerane me 6 vjet heqje lirie, nga të cilat vuajta 4 vjet dënim.

Sot unë ndodhem në vendlindjen time duke shpresuar të gjej një të ardhme më të mirë në atdhe.

A. Frashëri
Tiranë



Bota e iluzioneve dhe ëndrrave të mëdha

Ishte dimri i vitit '99 kur unë vendosa të nisesha drejt botës së ëndrrave dhe iluzioneve të mëdha, të cilat kishin vite që më mbanin peng. Në fillim vendosa të shkoja në Itali, pasi kisha aty disa nga njerëzit e mi. Italia m'u duk e bukur si në përrallë dhe unë mallkova veten që kisha ndenjur në Shqipëri aq gjatë, mallkim për të cilin u pendova shumë shpejt, sapo fillova të kërkoja punë.

Ishte dimër dhe mundësitë për punë në atë stinë janë më të pakta. Dokumente nuk kisha dhe kjo i shtonte vështirësitë. Megjithatë fati më erdhi në ndihmë dhe fillova punë në një punishte vere. Po mendoja se çdo gjë shkonte mirë dhe i premtova familjes që shumë shpejt do t'i dërgoja paratë e premtuara. Por do të vinte data 26 Mars, e cila do të shkatërronte gjithçka. Duke u kthyer nga puna mbrëmjen e asaj dite të mallkuar, pësova një aksident mjaft të rëndë. Shokët më çuan menjëherë në spital, por asnjë nga mjekët nuk pranoi të më kuronte, për shkak se nuk kisha dokumente. Vetëm pasi shokët paguan një shumë të madhe parash, mjekët morën përsipër të më mjekonin.

Kalova një natë me dhimbje të padurueshme në spitalin e Parias, pas së cilës m'u desh që të rrija goxha kohë në shtëpi pa lëvizur, sepse kisha shpatullën të thyer. Dhimbjet më mundonin shumë, por dhimbjen më të madhe e ndjeva në shpirt, kur mësova shkarkimin nga puna. Pronari nuk mund të më priste më shumë se tre ditë. Pas kësaj kuptova që humba gjithçka dhe jeta ime mori një rrugë të paditur.

Me ardhjen e verës fillova të ndjehesha me mirë dhe nisa të kërkoja punë sërish, por pa rezultat, pasi të gjithë italianët më shikonin si një njeri të pafuqishëm e të dobët për të punuar. I mërzitur e i pashpresë, u nisa drejt Zvicrës për të kërkuar azil. Si fillim, kërkesa ime u pranua dhe unë u ndjeva më i qetë. Aty shikoja njerëz që merreshin me shumë gjëra dhe nuk më vinte mirë kur shihja se shumë nga këta ishin shqiptarë.

Kaluan dy muaj dhe qeveria zvicerane e refuzoi kërkesën time për azil dhe vendosi që pas një jave të më kthente në vendin tim. Atëhere

kuptova se shqiptarët nuk kishin faj që merreshin me pislleqe dhe se për ta jeta ishte një sfidë e fortë.

Pas një lodhje të madhe dhe pas një çrregullimi mendor u gjenda përsëri në atdhe. Kjo është historia e dhimbshme jo vetëm e imja, por e çdo shqiptari që jeton në emigrim dhe që vuan pasojat e një politike të keqe nga politikanët e vendit të vet.

B. Dabërdini
Berat





Shpeshherë urreja veten time

Kur u largova nga Shqipëria, nuk u nisa me synimin për të shkuar dhe trafikuar në Zvicër, por thjesht si një emigrant ekonomik për të punuar. Por kur mbërrita në vend, dikush tek i cili unë kisha shumë besim më detyroi që të hyja në një rreth të rrezikshëm trafikantësh droge.

Veprimet e mia ranë në sy të policisë zvicerane dhe pas disa kohësh më arrestuan. Në burg arrita të kuptoja shumë gjëra për jetën time, pasi kohën e kisha me tepricë. Mësova si ta ndaja të mirën nga e keqja. Kishte raste që më mërzitej vetja, sepse kisha bërë diçka që s'duhej ta bëja, aq më tepër që s'ma lejonte as mosha. U pendova rëndë, pasi më kishte shkuar dëm një pjesë e jetës sime, e cila nuk kthehej më mbrapsht.

Gjatë vuajtjes së dënimit nuk pata ndonjë rast keqtrajtimi. E vetmja gjë e asaj kohe që më le një shije shumë të hidhur edhe tani kur e kujtoj është gjesti i një njeriut tim të afërm që i premtoi babait se do të bënte çmos të më nxirrte nga burgu kundrejt një shume të mirë parash. Babai e besoi, shiti shtëpinë dhe ia dha të gjitha paratë atij njeriu mashtrues, i cili, me t'i marrë, u zhduk pa lënë gjurmë.

Këtë ngjarje e mora vesh vetëm kur u ktheva në Shqipëri dhe që atë ditë rashë në pesimizëm. Vendosa të ndërtoja një strehë ku të fusja kokën, por pa pará nuk mund të bësh asgjë. Nuk kam as ndonjë zanat që të më japë bukë, por dua të punoj dhe të mos merrem më kurrë me poshtërsira. Dua të jem dhe unë si gjithë të tjerët.

Histori anonime

Realiteti në botë është më zhgënjyes se ai shqiptar



Gjithnjë kisha ëndërruar të emigroja diku në Evropë. Jo për hobi apo sepse më ishte neveritur vendi im, por për të siguruar disa të ardhura më shumë dhe përmirësuar jetesën. Dua të theksoj këtu se e dua vendin tim dhe nuk e ndërroj me asnjë vend tjetër. Kjo mundësi m'u krijua pas vitit 1991 kur u bë ndërimi i sistemeve. Mezi arrita të siguroja të hollat për të blerë në tregun e zi një vizë Shengen, duke menduar se ajo do të më hapte dyert e parajsës.

Kështu u rropata dy javë në Itali për të siguruar lejeqëndrimin e përkohshëm. Por nuk munda të bëja dot gjë e për më tepër i shpenzova të gjitha të hollat që kisha me vete. Në biseda me shokë mësova se në Francë ishte më e lehtë të fitoje të drejtën e azilit. Kjo ishte shumë larg asaj që kisha ëndërruar, por për momentin do të ishte sidoqoftë një zgjidhje, aq më tepër për problemet shëndetësore që nuk më linin të qetë.

Në Grenobël të Francës realiteti që jetova ishte edhe më zhgënjyes se në Itali, kështu që shumë shpejt vendosa të largohesha dhe që andej. Kisha dëgjuar për “mrekullinë” zvicerane dhe mendova që, me një punë disajvare, do të mundja të siguroja të paktën të hollat për një kontroll mjekësor dhe ndërhyrje kirurgjikale. Me shumë vështirësi arrita të hyja në Gjenevë ku takova një djalë nga Durrësi, i cili u tregua i gatshëm të më strehonte për një muaj dhe të më orientonte në profesionin e ri. Sigurisht që e dija që po bëja diçka jo të mirë, madje të dëmshme, por varfëria e sidomos shëndeti i dobët ma humbën arsyen. Kështu kalova tre muaj e gjysmë burg të vështirë, ku pata kohë të tepërt të reflektoja për të shkuarën e sidomos për të ardhmen.

Për të mos e zgjatur shumë si dhe për ta zhdukur sa më shpejt nga kujtesa atë periudhë të shëmtuar të jetës sime, mendoj se s'ka mënyrë më të mirë për të filluar një jetë të re, se sa të mësosh një profesion të ri e të kesh një punë të re në vendin tënd.

D. Tepelena
Berat



Askujt s'i kam bërë gjë të keqe

Edhe unë si çdo i ri, e mora jetën me optimizëm. Por që në moshë të re filluan peripeçitë. Sapo hyra në vitin e parë të gjimnazit, m'u vra xhaxhai. Thanë se ishte vrarë pas një zënke banale, në mes të qytetit. Pas kësaj dëgjova për një farë kanuni që vepron në malësi, në Veri të Shqipërisë. Duhej të merrnim masa, të ngujoheshim brenda shtëpisë. Por unë nuk pranova. Dëshiroja patjetër të vazhdoja shkollën.

Nuk kaloi shumë kohë kur një tjetër lajm i zi e pushtoi familjen tonë. Në qendër të Tiranës na vranë dy kushërinj të parë. Ata ishin fare të rinj. Njëri dy vjet më i madh se unë, tjetrin e kisha moshatar. I kishin masakruar keq. Arsyeya ishte vetëm mbiemri Nezaj. Gratë u veshën me të zeza. Po kështu edhe nëna ime. Kjo më bëri të kridhesha në një det trishtimi.

Vendosa të largohesha jashtë vendit. Kisha dëgjuar për skafet që niseshin nga Vlora. Kështu mora pará hua dhe u nisa. Pasi kalova Italinë, hyra për në Zvicër. Doja të filloja ndonjë punë që të ndihmoja më pas familjen time. Por nuk kisha asnjë lloj dokumenti, kështu që një ditë më kapi policia dhe më futi në burg. Tani nuk mendoja më për veten, por për familjen, nënën e sëmurë invalide që kisha lënë në shtëpi. Mendoja se si do ta laja borxhin. Të jesh në borxh për ne është turp i madh.

Pas disa ditësh më kthyen në Shqipëri. As vetë s'dija ku të shkoja. Qëndrova disa ditë te daja në Tiranë. Dikush më orientoi te një zyrë. Më pritën shumë mirë. Me ndihmën e disa të njohurve të mi fillova punë. Shkoj natën dhe kthehem po natën. më shoqëron nëna ose motra sepse kanuni thotë se po të jesh i shoqëruar me femra, nuk të nget njeri. Kam marrë disa kërcënime. Në telefon më vijnë mesazhe: "Tani radhën e ke ti". Kjo më brengos shumë. Askujt s'i kam bërë gjë të keqe.

"Kape të Ardhmen" është e vetmja shpresë e imja. Projekti në fjalë më bën të ndjehem i ndihmuar dhe i ngushëlluar.

G. Nezaj
Tropojë

Askush nuk e braktis tokën e vet pa arsye të forta



Quhem Genci dhe banoj në qytetin e Shkodrës. Para se të filloj me historinë time të emigrimit, kërkoj së pari që të kuptoni diçka, që e them me sinqeritet të plotë: asnjë shtetas shqiptar nuk është i gatshëm ta braktisë tokën e vet, pa patur arsye të forta. Një nga këta persona jam edhe unë.

Kur u largova nga Shqipëria, situata ishte nga më të zymtat që ka kaluar kombi ynë. Shteti pothuajse nuk funksiononte. Qeverisjen e vendit e kishte marrë në dorë turma, e cila kontrollonte gjithçka. Kjo periudhë i përket vitit 1997. Për të kërkuar diçka më të mirë dhe për të shpëtuar nga kaosi, vendosa të shkoja në Zvicër, pasi kisha dëgjuar se është një ndër vendet e pakta ku të drejtat e njeriut respektohen më shumë se në çdo vend tjetër të Evropës. Hyra në Zvicër nga dhjetori i vitit 1997 dhe kërkova azil politik si nënshtetas i Kosovës. E bëra këtë ndryshim identiteti për shkak të informacionit që kisha nga disa të njohur të mi që kishin qenë atje se, vetëm po të paraqitesha si shqiptar i Kosovës, do të fitoja leje qëndrimi.

Pata disa peripeci në fillim dha ma ndryshuan disa herë vendbanimin, derisa më caktuan në një qytet të vogël pranë Bernës. Aty ndoqa një kurs të gjuhës gjermane dhe më vonë edhe një kurs tjetër për elektroteknikë në Bernë. Në përfundim, pas një viti mora një diplomë me rezultate të mira. Qendrova 20 muaj në Zvicër me lejeqëndrim të rregullt të lëshuar nga autoritetet përkatëse. Kthimi në Shqipëri është bërë krejt privat nga ana ime dhe me iniciativën time, për arsye familjare.

G. Spahia
Shkodër



Jam i ri, në kulmin e energjive, por nuk kam ku gjej punë

Më 10 Janar 2001 u nisa nga Shqipëria për në Itali me traqetin e linjës Durrës-Bari. Nga Bari udhëtova me tren drejt Komos dhe pastaj një mik i familjes më kaloi me makinë në Kiaso të Zvicrës ku më priste daja. Në fillim u dorëzova në kampin e Kiasos, në të cilin qëndrova rreth një muaj e gjysmë. Më vonë më transferuan në Kantonin Glarus, ku qëndrova rreth 2 muaj. Ky është vend turistik, prandaj mundësia për t'u punësuar aty është shumë e pakët. Jetonim vetëm me asistencën që na jepte bashkia.

Në Maj më erdhi negativ i që të largohesha nga Zvicra. Kisha kohë deri në fund të muajit. Shkova te daja im që jetonte në kantonin e Xugut dhe të dy bashkë u shpërngulëm në Bazel ku morëm një apartament me qera. Jetonim duke bërë punë të ndryshme ditore. Kjo zgjati rreth 3 muaj.

Në fund të korrikut na ndaluan dhe, ngaqë nuk kishim dokumente, na mbajtën përreth një muaj në polici, deri sa na përgatitën dokumentet e kthimit nëpërmjet konsullatës sonë në Zvicër. Më datën 25 Gusht na kthyen nga aeroporti i Zyrihut në Tiranë.

Jeta në Shqipëri është shumë e vështirë. Jam i ri, jam në kulmin e energjive dhe mundësi punësimi nuk kam. Jetoj në shtëpi vetë i katërt. Kam një vëlla më të vogël, nëna dhe babai janë pa punë. Ja pse u detyrova të merrja rrugën e emigracionit.

Histori pa emër autori

Për një muaj mësova dhe kuptova shumë



Isha i ri, isha i fuqishëm, doja të punoja, trokita në shumë dyer për punë, por vetëm përgjigja “jo” më priste. Çdo fund muaji paguanim qeranë dhe detyrimet e tjera dhe nuk na mbetej asnjë lek. Familja ime e kishte shumë e vështirë t’ia dilte mbanë. Në këto kushte, u detyrova të gjeja lekë borxh te njerëzit e mi për të emigruar në Itali.

U nisa nga bregdeti i Vlorës. Mora parasysh çdo gjë që mund të më ndodhte. Hipëm në një skaf të vogël me shumë të tjerë si unë, që prisnin të frikësuar të linin vendin. Pas tre orësh udhëtimi në një det me tallaz iu afruam bregdetit italian dhe skafisti na kërcënoi që pjesën që mbetej, gati 50 metra, ta bënim me not. U detyruam të hidheshim në det. Kur dolëm në breg ishte mesnatë. Pasi u sigurova që isha mirë, hoqa rrobat e lagura, i ndera në disa shkurre dhe prita të zbardhte mëngjesi.

Por nuk qëndrova në Itali, pasi ëndërroja të shkoja në Zvicër, në atë vend, siç ma kishin përshkruar, shumë të bukur. Kur mbërrita në vend, shihja si i habitur gjithçka që më rrokte syri, ndërsa xhepat i kisha bosh. Plani im ishte të siguroja statusin e azilantit dhe të punësohesha diku. Kisha dëgjuar se qeveria zvicerane t’i ofronte këto mundësi.

Natën e parë në qytetin e Zyrihut e kalova në një park. Të nesërmen më duhej patjetër të takoja dikë që të më ndihmonte. Për fatin tim të keq, takova rastësisht një kosovar. I kërkova të më tregonte ku ndodhej azili. Ai u tregua i gatshëm të më ndihmonte dhe pasi më dha një drekë, më tha se do më ofronte një punë, që për mua ishte shumë e lehtë dhe, më e rëndësishmja, do të paguhesha që atë ditë. Më dha dy paketa cigare t’i shisja dhe më tha se ishte hashash që kushtonte. Gjithashtu më dha edhe 80 franga që të blija ndonjë gjë për vete.

Po ecja rrugëve të Zyrihut, kur më ndaloi policia. Më morën në pyetje. E tregova ngjarjen ashtu si më kishte ndodhur në të vërtetë. Më çuan në një burg afër një aeroporti ku qëndrova një muaj. Në burg u mërzita shumë dhe e kuptova që isha treguar mendjelehtë. Kosovari kishte dashur të më shfrytëzonte. Për një muaj, mësova dhe kuptova shumë gjëra që nuk i dija më parë.

E. Behari
Berat



Politikanë, ktheni kokën nga populli!

Si shumë të tjerë edhe unë e mora rrugën e Zvicrës për të punuar dhe për të siguruar një jetë sa më normale. Arsyeja e largimit nga Shqipëria ishte papunësia dhe kushtet e vështira për të jetuar. Munda të siguroja një vizë Shengen në ambasadën greke në Tiranë dhe u nisa për në Greqi më 10 Korrik 2002. Pas disa peripecish dhe problemesh që pata në kufi, u bë e mundur që unë të realizoja ëndrrën time. Arrita në Athinë dhe preva biletën e avionit për në Shtutgart. Si mbërrita në Gjermani, vendosa të udhëtoja me tren për në perëndim të vendit, në një qytet në kufi me Zvicrën.

Arrita të hyja në Zvicër ku u përballa me vështirësitë e para. Pas një farë kohe munda të gjeja një punë dymujore. Por puna mbaroi shumë shpejt dhe unë vendosa të kërkoja azil politik, gjë që nuk e bëra qysh në fillim. Por nuk ma pranuan kërkesën, sepse Shqipëria konsiderohej vend i sigurt dhe sipas ligjit, unë nuk mund të përfitoja statusin e azilantit.

Papunësia, mungesa e shokëve, jeta shumë e shtrenjtë aty më bënë të mërzhitesha jashtë mase. Më e keqja ishte kur shkoja në një kafene që popullohej nga shqiptarë. Nuk mund të duroja komentet që bënin shqiptarët nga Maqedonia dhe Kosova kur dëgjonin lajmet nga Shqipëria dhe shikonin politikanët tanë dhe deputetët në Parlament. Me këtë rast do t'iu lutesha shumë qeveritarëve e politikanëve dhe të gjithë atyre që janë në pushtet që ta kthejnë kokën nga populli e në veçanti nga emigrantët, që edhe ata të ndihen të sigurt e të barabartë me popujt e tjerë.

Kur prisja të filloja punë në Zvicër, më zuri policia. Atëherë e ndjeva veten përfundimisht të humbur dhe të braktisur. Sot, duke gjykuar me gjak të ftohtë, mund të them se prapëseprapë diçka kam fituar në burgun e Zvicrës: Rregullat e mirësjelljes!

Z. Hysa
Hotolisht, Librazhd

Pendimi më i madh



Ka qenë fundi i muajit gusht kur unë, i ndodhur në një gjendje të vështirë ekonomike, vendosa të nisesha për në Gjermani. U nisa me gomone, për arsye se paratë nuk më mjaftonin për të blerë një vizë të rregullt. Pas një udhëtimi për jetë a vdekje në mes të deti të tërbuar, arritëm në tokën italiane. Pritëm disa orë në pyll, derisa erdhën disa taksi që na çuan në Bari. Nga Bari u hodha në Milano dhe aty dy shqiptarë më nisën për në Zyrih. Kur mbërrita në Zyrih, e pashë se nuk më mjaftonin paratë për në Gjermani ku unë dëshiroja të shkoja dhe vendosa të qëndroja aty deri sa të bëja paratë e rrugës.

Dy ditë jam endur rrugëve të Zyrihut dhe kam fjetur jashtë. Ditën e tretë takova rastësisht një kosovar, i cili më mori në shtëpinë e tij dhe më ofroi një punë. Kur më tregoi punën që duhet të bëja, në çastin e parë nuk pranova, por më pas e ndava mendjen të punoja një javë, sa të bëja paratë që më duheshin. Por, që ditën e parë që fillova të shisja drogë, më kapi policia me çantën me dorë dhe unë u dënova për trafikim droge. Kështu u shua njëherë e përgjithmonë ëndrra ime për në Gjermani.

Gjatë ditëve të vuajtjes së dënimit në burg u pendova që u nisa në mënyrë klandestine, por pendimi më i madh ishte që u mora me shpërndarje droge. Tani kam ardhur në qytetin tim dhe po punoj si mekanik.

Me kaq po e mbyll rrëfimin tim, duke u betuar se s'kam për t'u marrë kurrë më me punë të tilla.

B. Lame
Berat



U detyrova të emigroja...

Quhem Fatjon Nako dhe jam lindur në Tiranë. Kam nënën, babanë dhe një vëlla më të vogël se veten. Jetonim në kushte jo të mira ekonomike, babai ishte i papunë, nëna e sëmurë dhe e papunë dhe vëllai i vogël në shkollë. Mbaheshim vetëm me asistencën e babait. I detyruar nga këto kushte të vështira, u detyrova të emigroja.

Arrita të siguroja një vizë Shengen dhe u nisa për në Greqi bashkë me një shokun tim. Qëndruam atje vetëm një ditë dhe të nesërmen u nisëm për në Francë, Paris. Nga Parisi morëm trenin ekspres deri në Kalais, një qytet që ndodhet në kufirin Francë-Angli. Kur arritëm në Kalais, ndërruam vagon, i grisëm pasaportat dhe, kur erdhi policia të na kontrollonte, i thamë që harruam të zbrisnim. Nuk na thanë gjë, por e kuptuan që gënijem.

Kur arritëm në Londër, na ndaloi policia dhe filluan të na pyesnin për gjithçka. Unë lajmërova dajën, i cili kishte një vit që ndodhej me familjen në Portsmouth. Ai erdhi dhe më çoi në familjen e tij.

Koha e qëndrimit në Angli ishte e shkurtër. Punova pak, ndihmoja djalin e dajës, i cili punonte në një pab. Por s'kaloi shumë dhe dajës i erdhi negativ i kthimit. Pas një muaji më erdhi edhe mua dhe më 16 Shtator 2003 u ktheva në Shqipëri.

F. Nako
Tiranë

Doja të kthehesha në vendin tim



Jam Erioni, një i ri si të gjithë të tjerët që janë përfshirë në programin e riintegritimit të projektit “Kape të Ardhamen”. Në këto radhë do desha të përshkruaj shkurtas historinë e migrimit tim në Zvicër.

Isha vetëm 20 vjeç kur u largova nga Shkodra ime dhe mora rrugën e kurbetit. Lashë në shtëpi vetëm nënën dhe babain, sepse jam djalë i vetëm. U nisa për në Zvicër me qëllimin që të ndërtoja një jetë sa më normale, të merresha me ndonjë punë të ndershme dhe të fitoja ca para për të jetuar si njeri. Në atë kohë, (ishte viti 1997), kishte shumë shqiptarë që merreshin me trafik droge. Sinqerisht e them se nuk u nisa asfare me mendimin që të bëja të njëjtën gjë, por shoqëria që zura në Zvicër ishte e përbërë nga njerëz që merreshin me këtë punë dhe unë mbeta si të thuash viktima e radhës.

Pa bërë 5 muaj e gjysmë, u arrestova nga policia zvicerane dhe u dënova me 7 vjet burg. Në fakt nga këta bëra vetëm 56 muaj, përfitova një ulje dënimi, siç bëhet me të gjithë ata që futen në burg për herë të parë. Por, sipas vendimit të gjyqit, e kam të ndaluar të hyj në Zvicër për 15 vjet.

Të them të drejtën, kur mora dënimin u ndjeva shumë keq, por kur dy javë më vonë më njoftuan për vdekjen e babait, hidhërimi im arriti kulmin. M’u deshën pesë muaj që ta merrja disi veten. Dënimi i rëndë, vdekja e babait, nëna e vetmuar në shtëpi me gjithë ato halle më peshonin si gur i rëndë në shpirt. Me forcat e mia, me dhembshurinë e nënës që mendohej të ma hiqte mërzinë në telefon dhe me ndihmën e zotit, arrita që ta ktheja sadopak dhimbjen në forcë.

Nga fundi i periudhës së dënimit, më transferuan në një burg pak më të lirë prej të cilit mund të arratisesha fare kollaj. Por nuk e bëra këtë, sepse nuk doja ta përlyeja më veten dhe t’i shkaktoja të tjera telashe vetes e shtetit zviceran. Doja vetëm të kthehesha në vendin tim dhe t’i rrija afër nënës që më priste me padurim.

Kjo është shkurtimisht historia ime e emigrimit. Po e mbyll, duke ju falenderuar për ndihmën që u ofroni të gjithë personave nevojtarë.

Erion D.
Shkodër



I kam rrahur udhët e botës që në moshën 14-vjeçare

I kam rrahur udhët e botës që në moshën 14-vjeçare. Kjo sepse familja ime ishte e madhe dhe me të ardhura fare të pakta. Në fillim emigrova në Greqi. Udhëtova 5 ditë e net më këmbë derisa kalova kufirin. Nuk mund t'i harroj kurrë vuajtjet dhe mundimet. Pas dy ditësh ecjesh, nuk pata asgjë që të fusja në gojë, as bukë, as ujë, por megjithatë arrita në vend.


Në Greqi nuk më eci. U enda kot rrugëve për ditë me radhë dhe nuk gjeta punë kurrkund, kështuqë u detyrova të kthehesha në shtëpi.

Pastaj mendova të shkoja në Zvicër. U nisa me skaf drejt Italisë në një udhëtim shumë të vështirë dhe me shumë shpenzime. Paratë e udhëtimit i kisha marrë borxh te disa të afërm.

Me të arritur në Zvicër, më kapi menjëherë policia, se isha pa dokumente. Bëra pesë javë burg dhe pastaj më kthyen në Shqipëri. Familjen e gjeta në po ato kushte të vështira, vetëm babai kishte mundur të gjente një punë dosido.

Y. Agaj
Tiranë

Rruga që zgjodha nuk ishte rruga e duhur



Kam emigruar për herë të parë në Zvicër në vitin 1997. Jam larguar nga Shqipëria me mendimin që të gjeja një vendstrehim të përkohshëm, pasi në vend gjendja po keqësohej nga dita në ditë. U nisa në shkurt të vitit 1997 me skaf drejt Italisë, ku qëndrova disa ditë. Që andej kalova në Zvicër, ku kërkova azil në qytetin e Bazelit.

Pas një jave më transferuan në qytetin e Bernës, ku ndenja rreth një muaj e gjysmë. Në këtë periudhë kohe dilja shëtitje dhe takohesha edhe me shqiptarë të tjerë. Nisur nga dëshira për të fituar diçka si bashkatdhetarët e mi, fillova të bëja të njëjtën punë, pra shpërndarje droge. Për fat të keq, ne shqiptarët shkojmë me turmën. Kështu fillova të gaboja dhe të mos e respektoja rregulloren e azilit. Policia e Kantonit të Bernës pas kësaj më dërgoi një letër në kamp ku shkruhej se kisha një javë kohë për t'u larguar nga Zvicra, pasi isha njeri i padëshiruar për shtetin zviceran. Nuk e bëra të gjatë dhe u largova.

Më pas shkova përsëri në Zvicër me mendimin për të bërë pará dhe pak për aventurë. Gabova sërisht. Nuk e kam patur të gjatë qëndrimin tim në Zvicër, edhe pse kam qenë tri herë atje. Herën e tretë vuajta dënimin e merituar prej 16 muajsh, i cili më bindi se rruga që zgjodha nuk ishte rruga e duhur.

A. Esaj
Berat



Ne kemi një vend plot me halle, vuajtje e mjerim

Unë jam një ish emigrant, i cili ka bërë një rrugë të vështirë për të mbërritur në një vend ku mbizotëronte qetësia e ligji.

E nisa rrugën me shpresën që të siguroja bukën e gojës për vete dhe familjen time, e cila përbëhet nga 5 persona. Kur arrita në Londër, më dukej sikur isha në ëndërr, por në fakt, gjithçka që shikoja ishte e vërtetë. Shtet me ligje, njerëz humanë dhe bukuri natyrore. Punë kishte mjaft, por “jo”-ja dominonte kudo. Pasuria e vendit ishte e papërfytyrueshme. Jeta e njerëzve ishte një jetë luksi. Kudo kishte vila e zburime. Njerëzit tregonin kulturë, dashamirësi. Punën që bëje ta vlerësonin edhe më tepër nga ç’e meritoje. Ndoshta edhe vendet e tjera janë si Anglia, por mua më dukej një vend i rrallë. Ose më dukej kështu, pasi ne kemi një vend plot me halle, vuajtje e mjerim.

Të jetosh në Angli është sikur të jetosh në parajsë. Është vërtet një ëndërr e bukur, për mua e prerë në mes, që vështirë se realizohej.

P. Kola
Durrës

Shqipëria ka nevojë për brezin e ri që nuk i mungon intelijenca



Edhe unë, si shumë të rinj shqiptarë, i ndikuar nga kushtet e vështira ekonomike dhe e ardhmja e pashpresë, u nisa drejt një jete më të mirë. Pas një emigrimi ta pasuksesshëm në Greqi, u drejtova drejt Italisë. Një udhëtim i tmerrshëm me skaf, që nuk besoj të mos e kenit dëgjuar, më çoi deri në brigjet e Barit.

Porsa mbërrita atje, i telefonova disa miqve që jetonin në Milano dhe ata më orientuan se ç'tren duhej të merrja. Nuk e mohoj sa bukur e kalova në fillim, pasi koha e lirë nuk më mungonte. Brenda tre muajve që ndenja në Milano u përpoqa të gjeja një punë, por për kushtet e mia ishte e vështirë.

Duke parë këtë gjendje të pashpresë, u lidha me disa kushërinj të mi që ndodheshin në Mançester të Britanisë e Madhe. Ata më adresuan te një person në Francë që, kundrejt 1000 frangave, do të më ndihmonte të kaloja në Angli. As që mund të mendohej se kisha aq para, por sidoqoftë, me ndihmën e shokëve e mblodha shumën e kërkuar dhe arrita ta kaloja kufirin për në Francë pa shumë probleme.

Personi që gjeta në Francë më ndihmoi të hipja në një kamion bashkë me disa shqiptarë të tjerë dhe, pas një udhëtimi me traget, u gjendëm në Angli. Rreziku më i madh për ne ishte kur të zbrisnim nga kamioni, por e kaluam me sukses. Mbas 20 minutash arritëm në Londër me taksi dhe unë mora trenin për në Mançester. Takova kushërinjtë e mi, që pas disa ditësh më adresuan në një zyrë emigracioni. U paraqita si shqiptar nga Maqedonia, sipas sugjerimit të një avokati të zonës. Fillova punë në të zezë, pasi nuk m'u dha e drejta për leje qëndrimi. Por nuk munda të vazhdoja gjatë, sepse më detyruan të kthehem.

Dua ta mbyll këtë histori timen me kthimin në Shqipëri. E vetmja gjë që më pëlqen këtu është iniciativa juaj me programin “Kape të Ardhmen”, i cili u jep mundësi të rinjve shqiptarë të ndërtojnë jetën këtu në vendin e tyre, në Shqipërinë, e cila ka nevojë për brezin e ri që nuk i mungon intelijenca.

A. Bezhani
Elbasan



S'kam më shpresa të kota

Jam lindur në fshatin Dragostunjë të rrethit Librazhd. Në vitin 1998 emigrova në Itali. U nisa me skaf nga Vlora bashkë me një komshiun tim. Me të mbërritur në Itali, na kapi policia dhe na dha 15 ditë afat për t'u larguar nga vendi, ndryshe do të na rrasnin në burg. U nisëm për në Francë ku ndodhi e njëjta gjë, na lanë vetëm 48 orë kohë për t'u larguar nga Franca.

Kështu vendosëm të shkonim në Angli. Pas shumë vështirësish dhe sakrificash arritëm në Angli. Në fillim shteti na ofroi përkrahje sociale dhe për gjashtë muaj, nuk na u lejua të punonim. Kur filluam punë, përkrahja sociale nga shteti u ndërpre. Punonim me rrogë minimale, për arsye të mosnjohjes së gjuhës. Me rrogën që merrnim duhej të paguanim qeranë e shtëpisë, dritat, ujin, ushqimin etj. Kështu ne punonim sa për të jetuar dhe me shumë sakrifica ndihmonim edhe pak familjen.

Gjatë gjithë kohës së qëndrimit tonë në Angli, prisnim me shpresë të fitonim statusin e emigrantit që nuk na e dhanë asnjëherë. I detyruar nga kushtet familjare dhe nga stresi i pritjes pa shpresë u ktheva dhe tani jetoj në rrethinat e Durrësit së bashku me gruan dhe katër fëmijët.

Xh. K.
Durrës

Jeta atje ishte tepër e vështirë



U nisa në emigrim për një jetë më të mirë. I thashë tim eti se doja të provoja fatin dhe ai mori para borxh që të blija një vizë. Pagova tremijë Euro dhe shkova me traget deri në Bari. Që aty u drejtova për në Milano dhe qëndrova disa ditë te ca shokë.

Meqenëse nuk arrita të gjeja punë, vendosa të largohesha për në Zvicër ku më priste një i njohuri im. Ai më çoi në një kamp azilantësh ku më regjistruan dhe më dhanë një leje qëndrimi njëmuajore. Gjatë kësaj periudhe u përpoqa të gjeja ndonjë punë, por e kisha shumë të vështirë. Ditët kalonin dhe unë nuk kisha më pará. Me drogë nuk doja të merresha.

Ndërkohë më thanë se, me të më skaduar afati i qëndrimit, do të më kthenin për në Shqipëri. Duke mos patur rrugë tjetër, vendosa aty për aty të largohesha për në Gjermani. Me anë të një personi që merrej me këto punë arrita të shkoja në Dyseldorf. Aty u regjistrova përsëri në një kamp azilantësh. E pashë që mundësia për punë nuk ekzistonte, numri i të papunëve ishte shumë i madh, jeta atje ishte tepër e vështirë, punë të pandershme nuk doja të bëja. Fillova të mërzitesha duke ndenjur kot. Me babanë flisja shpesh në telefon dhe i thoja që nuk duroja dot më atje. Një ditë më kapi policia dhe më ktheu në Rinas, pasi leja e qëndrimit më kishte mbaruar.

Kjo, me pak fjalë, ishte historia ime e migrimit.

Sh. Mhilli
Pukë



Nga Zvicra nxora tri mësimë të rëndësishme...

Jam një djalë nga qyteti i Beratit, por tani jetoj në Tiranë. Kam emigruar për herë të parë në Greqi, ku kam punuar punë bujqësie, në ara dhe fusha dhe kam ndjerë përbuzjen, sharjet e pronarëve grekë si dhe mospagimin e djersës së derdhur. Më dëbuan me forcë nga Greqia, me pretekstin se nuk zotëroja dokumente të rregullta qëndrimi.


Më pas u hodha në Itali me skaf. Jam endur sa andej-këndej nëpër Itali herë me punë e herë pa punë.

Kushtet më detyruan të emigroja përsëri, por këtë herë në Zvicër. Shoqërimi me shokë të këqinj, ishte arsyeja që më çoi në dyert e burgut. Në këtë rast ligji në Zvicër është i ashpër dhe unë u dënova njësoj sikur të kisha kryer vetë veprimtari të paligjshme. Por dua ta them, se në dallim nga vendet e tjera ku kam qenë, shteti zviceran të trajtonte ndryshe. Policia, hetuesit, personeli i burgut, punonjësit socialë silleshin me ne në mënyrë normale, të ndihmonin të lidheshe me familjen, avokatin, të mësonin zanat e shumë të tjera.

Ndoshta nga Zvicra nuk fitova shumë pasuri, por nxora tri mësimë të rëndësishme: të jesh human, i ndershëm dhe punëtor, po qe se do që të bësh pjesë në një shoqëri që ecën përpara.

A. Topi
Tiranë

Një jetë më e mirë në perëndim?



U nisa drejt perëndimit, duke shpresuar të gjeja një të ardhme më të mirë. Dy shokë të mi më premtuan se do të më çonin në Zvicër dhe do të më siguronin punë të rehatshme. Kaluam nga Mali i Zi, Kroacia dhe Sllovenia dhe më pas hipëm në një tren dhe zbritëm në Milano. Që aty, së bashku me disa shokë, morëm një taksì dhe u larguam për në qytetin e Bazelit në Zvicër.

Në Bazel qëndrova rreth një muaj. Shokët me të cilët ndaja shtëpinë u përfshinë në aktivitetin e shpërndarjes së drogës. Unë nuk desha të bëja të njëjtën gjë dhe u largova drejt Gjermanisë. Atje u vendosa në Hanover ku qëndrova rreth 4 muaj duke kërkuar punë çdo ditë, por ishte e pamundur të gjeja. Edhe atje më ofruan mundësinë për t' u marrë me punë të paligjshme.

U mërzita pa masë nga hallet dhe problemet që kishte familja ime në Shqipëri dhe vendosa që të kthehesha. U dorëzova tek autoritetet gjermane, të cilët më prenë biletën e avionit dhe më kthyen në Rinas.

Kjo ishte shkurtimisht historia ime e emigrimit.

A. Rama
Tropojë



Humba 5 vitet më të bukura të rinisë sime...

Me dëshirën time vendosa t'ju tregoj për jetën time në Zvicrën e ëndrrave që për mua dhe për fajin tim u bë burg i viteve më të bukura të rinisë time.

Jam një djalë 23 vjeçar nga qyteti i Beratit. Familja ime përbëhej prej 5 personash; prindërit e moshuar pensionistë, unë dhe dy motra. Gjendja shumë e keqe ekonomike e familjes më detyroi të emigroja qysh në moshën 16 vjeçare. Kur mbusha 17 vjeç, vajta në Zvicër ku u vendosa në një azil në qytetin e Lozanës dhe ndenja aty një vit.

Gabimi i parë: duke qenë në moshë të vogël, njerëz të panjohur më shfrytëzuan, gjoja duke më ofruar ndihmë. Ata më futën në punë si shitës të mallit të tyre. Unë nuk njihja asnjëri, ndërsa ata i kishin krijuar lidhjet me kohë. Më kapi policia dhe më dënuan, ndonëse u tregova i sinqertë.

Gabimi i dytë: mungesa e punës në Shqipëri si dhe gjendja e keqe ekonomike më detyruan të emigroja përsëri. Kështu nga fundi i Janarit 2000, u nisa me skaf nga Vlora. Një natë para nisjes sime ishte mbytur një skaf me 65 persona, vetëm mendimi më tmerronte. Hipëm në skafin ku ishin afro 40 veta, midis të cilëve edhe gra dhe fëmijë, edhe pse kapaciteti i skafit ishte vetëm për 16 vetë. Bënte shumë ftohtë, binte shi, deti ishte i trazuar. Ishte mezi i natës, kur ne të struktur kurriz më kurriz me njëri-tjetrin prisnim të niseshim. Qetësinë tonë e prishte kërcënimi i padronit të skafit, i cili na paralajmëronte të mos lëvizim nga vendi dhe të mos bënim dritë, se ndryshe do të na e priste kokën. Orët kalonin, qielli nxinte, ndërsa herë pas here shkreptinte rrufeja. Mbas tre orësh shi e tufan deti u qetësua. U dha urdhri për nisje. Udhëtonim në errësirë të plotë, duke pritur nga çasti në çast vdekjen e sigurt. Mbas një ore rrugë deti filloi papë të egërsohej. Në këto çaste na dhanë urdhër të hidhnim në det gjithçka që kishim me vete, se stafi kishte shumë peshë. I hodhëm të gjitha plaçkat tona nga frika se mos na jepnin një të shtyrë dhe na hidhnin në det edhe ne për lehtësim peshe. Pas dy orësh ankthi dhe lemerie iu afruam bregut italian. “Hidhuni me not” na kërcënoi timonieri i skafit. U hodhëm në ujën akull të ftohtë. Shumë veta nuk dinin as not, por timonieri dhe shokët e tij i flakën në det pa

mëshirë. Dola në breg duke u dridhur nga të ftohtët. Më rroba të lagura, me ankth në zemër u vërdallisa nëpër pyllin e panjohur. U gdhiva i strukur, i vetmuar, i pangrënë dhe i gjakosur nga degët e drurëve.

Gabimi i tretë dhe tragjedia ime: hyrjen në Zvicër e kisha të ndaluar, por mendova ta provoja edhe njëherë se mos gjeja ndonjë punë të ndershme. Prania ime ra në sy të disa shqiptarëve që m'u hoqën si miq. Në ditën e tretë të mbërritjes sime më detyruan të hipja në një makinë që transportonte drogë. Unë pranova të hipja pa e ditur se ç'kishte brenda. Makina u ndalua nga policia dhe unë u akuzova si transportues i saj, ndërsa personat e tjerë, që ishin edhe pronarë të makinës, dolën të palagur. E kuptova kurthin, por ishte tepër vonë; ata hodhën karremin dhe kapën gjahun, të cilin ia dorëzuan policisë për të mbrojtur veten. U dënova 30 muaj...

Unë nuk mund të hyj në Zvicër për disa vjet. Por ndoshta ndonjë ditë, kur të kem punuar ndershmërisht në Shqipëri, mund të shkoj për të mësuar në ndonjë shkollë ose si turist me familjen.

I. Isufi
Berat





Emigrimi, profesion i vjetër

Mbas vitit 1997 kur injoranca, mendjemadhësia, korrupsioni e shumë të tjera arritën kulmin dhe në veçanti krenaria absurde e të qenit shqiptar u thye përfundimisht, vendosa të largohesha nga Shqipëria. Ishte fillimi i vitit 1999, kur unë lashë nënën, babain, motrën, miqtë, shtëpinë dhe rrugët e këtij qyteti.

Kur kalova përtej Adriatikut pashë se shqiptarët vazhdonin të përfliteshin edhe më shumë përtej kufijve. Mediat e huaja, si të çmendura, nxirrnin lajme bombastike duke hedhur baltë e duke marrë nëpër gojë fatin e shqiptarëve të mjerë. Sepse dihet që ekskluzivet dhe skandalet tërheqin më shumë publikun, e në veçanti atë italian. Këta të fundit na akuzonin ne shqiptarët si mafiozë, duke harruar që vetë ata i kishin dhuruar botës mafien. Italianët dikur kanë qenë vetë një popull emigrantësh, por egoizmi dhe natyra e tyre kishte bërë që ta harronin, ose nuk u vinte shumë për shtat që ta kujtonin.

Vazhdova më tej dhe u vendosa në Zvicër. Atje të bëje ndonjë dokument, apo të filloje punë të ligjshme ishte e pamundur, në veçanti për ne shqiptarët. E vetmja gjë që të ofronin ishte azili, ku të jepnin një asistencë qesharake. Edhe sikur të doje të punoje, atje nuk të lejonin. Me pak fjalë nuk kishim zgjidhje tjetër. Ajo që dua të them është që ishim të imponuar për mëkat. Rruga ishte vetëm një: puna në të zezë.

Isha vetëm 22 vjeç kur më futën në burg dhe sot, tek po shkruaj këto radhë, jam 26. Për mua 22, 23, 24, 25 nuk kanë ekzistuar ndonjëherë. I privuar nga çdo gjë. Dëshirat e asaj moshe ishin pa kufi, por unë jetoja dhe ëndërroja me atë çfarë shikoja në televizion. Me këto që po them nuk dua thjesht të qahem, përkundrazi, duke parë anën pozitive, them se mbas kësaj eksperience e ndiej veten më të fortë dhe më të pjekur.

Emigrimi është një profesion i vjetër dhe ne nuk jemi as të parët dhe as të fundit që e provojmë. Ajo që më gëzon dhe më jep shpresë është fakti që edhe këtu te ne kanë filluar të ngrihen struktura të veçanta për përkrahjen dhe rehabilitimin e të kthyerve nga emigracioni. Së fundmi, dua të përsënder dhe inkurajoj të gjithë ata njerëz që kanë marrë këtë iniciativë të re, për të shëruar këtë plagë të shoqërisë shqiptare. Punë të mbarë!

Edmond D.
Tiranë

Me padurim pres që një ditë Shqipëria të hyjë në Evropë



Shtator 2000. Pas mbarimit të shkollës së mesme dhe viteve të paharrueshme të gjimnazit filloja të kuptoja dhe ndieja problemet e familjes. Tashmë i kisha lënë pas vitet dhe shoqërinë e shkollës dhe duhet të mendoja më seriozisht për të ardhmen time. Kështu, pasi vrava mendjen gjatë, vendosa të emigroja në Itali ku kisha një të afërm.

Kalova dy muaj në Itali dhe dhe po bëja pjesë në armatën e shumë emigrantëve të tjerë që rrokulliseshin në vorbullën e papunësisë dhe vuajtjeve. Tashmë çdo gjë kishte marrë ngjyrat e një jete të ftohtë ku malli për familjen dhe për vendin ma copëtonin zemrën dita-ditës.

Pas disa muajve arrita të gjeja një punë dhe fillova të shlyeja borxhet që kisha marrë. U ngushëllova disi, pasi më në fund arrita edhe të vija diçka mënjane, por kjo s'qe e thënë të vazhdonte për një kohë të gjatë. Mbas disa zënkash me kushëririn tim mbeta në mes të katër rrugëve. Dëshpërimi dhe vuajtjet më dukeshin sikur po ma shkurtonin jetën. Pas disa ditësh endeje, arrita të gjeja një fabrikë të braktisur, e cila u shndërrua për mua në një strehë për të futur kokën. Ky ishte kulmi, por s'kisha nga ia mbaja.

Një vend i tillë ku kishte vetëm drogmenë dhe lypësa rrugësh nuk mund të shpëtonte pa u kontrolluar nga policia. Kështu më erdhi radha edhe mua: Duhej të largohesha nga Italia.

Aty më lindi ideja për të provuar fatin në Zvicër. U paraqita në zyrat përkatëse dhe kërkova azil politik. Aty kuptova si mund të jetojë tamam njeriu. Shkoja në shkollë rregullisht dhe respektoja të gjitha ligjet e shtetit zviceran. Por një ditë, gjashtë muaj më vonë, do të vinte dita më e hidhur për mua. Më dhanë një letër ku thuhej se duhej të largohesha nga Zvicra brenda 3 ditësh. Atëherë kuptova se një njeri i vetëm dhe i pafajshëm nuk mund t'i ndryshonte rregullat e kësaj bote të çmendur. Isha i lodhur me rrugën time të drejtë! Që atë moment vendosa të ecja edhe unë çmendurisht, siç ecën kjo botë e mbrapshtë dhe fillova të bëja gjithçka për të fituar ndonjë parë, rrugë e cila pas një muaji më çoi në burg.



Kështu mori fund historia ime e trishtë. Një muaj më vonë më dërguan në Shqipëri në gjirin e familjes sime.

Me padurim pres që një ditë Shqipëria të hyjë në Evropë dhe njerëzit si unë të mos jenë më të nënvleftësuar për faj të pasaportës që kemi. Shpresoj dhe uroj që kjo ditë të mos jetë e largët për ne shqiptarët, që forca dhe zgjuarsia për të ndërtuar jetën siç duhet nuk na mungon, edhe kur kjo botë e egër na detyron të bëjmë gjithçka për të jetuar.

Sh. Kërpica
Berat

Do të përpiqem të filloj një jetë të re këtu në vendin tim



Isha 17 vjeç dhe vazhdoja gjimnazin kur vendosa të emigroja. Nga gjendja ekonomike ishim shumë keq. Bisedova me disa të afërm që kisha në Itali që mund të më prisnin e të më ndihmonin me ndonjë punë. Prindërit nuk i vura në dijeni për këtë. Mora para borxh dhe u nisa me gomone për në Itali.

Në Itali qëndrova ca kohë me shpresë se do filloja punë, por nuk gjeta asnjë lloj punë. Filloja të humbja durimin, sidomos kur mendoja për paratë e udhëtimit të marra borxh. Një ditë takova rastësisht në një bar një djalë nga Durrësi. I tregova që kisha tre muaj pa punë dhe ai më sugjeroi të shkoja në Zvicër dhe të kërkoja azil politik. Sipas tij atje mund të më pajisnin me leje qëndrimi dhe mund të bëja një punë të ndershme.

Me ankth të madh i hipa trenit për në Zyrh dhe arrita atje pa patur probleme me policinë. Në stacionin e trenit të Zyrhut takova një kosovar, i cili më drejtoi për në Bazel, sepse atje, sipas tij, kisha më shumë shanse. Në Bazel u paraqita me pasaportën time personale. Duke u qarë hallin me improvizime mashtruese që i mësova aty brenda, përfitova lejeqëndrim për 3 muaj. Thashë se ia dola mbanë, por fillova të mërzitesha kur mësova se nuk kisha të drejtë pune. Ushqimi aty nuk ishte i mjaftueshëm dhe pagesa ishte e ulët (10 franga në javë). Vetëm një paketë cigare kushtonte 5 franga.

Por e keqja më e madhe ishte kur më erdhi negativi, sipas të cilit duhej të largohesha vetë nga Zvicra brenda 3 ditëve ose përndryshe do të më kthenin ata në Shqipëri. U largova i zhgënjyer nga azili. Kisha harxhuar 200.000 lekë të reja dhe nuk kisha fituar asgjë.

U përpoqa të bëja ndonjë punë ato tre ditë, por pikërisht në ditë e tretë, më kapi policia. Gjykata më dënoi me një muaj e gjysmë burg dhe pastaj më kthyen.

Ndoshta ata mendonin që s'do të shkelja më në Zvicër, por gjendja e keqe ekonomike dhe papjekuria e moshës më detyruan të shkoja sërish



atje, për të kaluar më pas në Gjermani. Atje më kapi përsëri policia dhe më dënoi me akuzën e shkeljes së vendit të ndaluar. Gjykata mori vendim për dy muaj burgim. I gjithi mundimi më shkoi kështu kot.

Pas ardhjes në Shqipëri dhe pas ndihmës suaj do të përpiqem të filloj një jetë të re këtu në vendin tim.

A. Civeja
Berat

Uroj që fjala “emigracion” të zhduket nga fjalori ynë i përditshëm



Historia ime e emigrimit, pavarësisht se është personale, besoj se do të jetë shumë e ngjashme me të tjerat. Kjo vjen ngaqë arsyet e emigrimit, mënyrat dhe rrethanat janë të njëjta për të gjithë shqiptarët.

Për herë të parë kam emigruar në Greqi, në moshën 16 vjeçare, në kohën e pushimeve verore. Ishte kontakti i parë me botën e panjohur për mua dhe nuk zgjati shumë. Në 1995 e provova fatin në Itali. Edhe aty nuk qëndrova shumë kohë, punë muajsh, dhe u nisa për në Gjermani. Nuk e pata jetën të gjatë edhe aty, se më kthyen shpejt.

Tani t'i kthehem dy rasteve të fundit. Nga fundi i vitit 1998 u nisa duke patur si objektiv Zvicrën. Arsyja kryesore e emigrimit ishte ajo ekonomike. Siç e dimë nga përvoja jonë shqiptare, ekonomia e dobët vjen nga një politikë e gabuar. Në një vend me ekonomi të dobët ku dhe vendi i punës është i pasigurt, çdo zyrtar mundohet të përfitojë për aq kohë sa është në post në mënyrat më të ndryshme. Kjo i hap rrugë korrupsionit që sa vjen e rritet. Pra arsyet ekonomike nuk mbeten thjesht arsye ekonomike, por janë shumë më komplekse seç mendohet.

Në Zvicër kërkova azil politik, duke u argumentuar kërkesën time me situatën problematike që mbizotëronte në Berat pas ngjarjeve të tmerrshme të '97-ës. Prita dy muaj të më jepej e drejta e azilit, por nuk m'u pranua kërkesa dhe kështu, duke mos pasur asnjë mundësi punësimi, vendosa të kthehesha në Shqipëri.

Realiteti i ashpër shqiptar më detyroi ta rimerrja këtë rrugë në Mars 1999. Sipas ligjit në Zvicër, mund të bësh kërkesë për azil deri në tri herë, por koha që nevojitet midis kërkesave duhet të jetë të paktën 4 muaj. Në pritje të këtij rregulli, për arsye mbijetese, u detyrova të merresha me punë të paligjshme, të cilën nuk më vjen mirë ta përmend. Dhe përfundimi është ai që quhet burg. Aq më tepër që ligji me shqiptarët zbatohet më me zell se me gjithë njerëzit me kombësi të tjera, sepse edhe shteti ynë e ambasada jonë na ndihmojnë shumë andej jashtë!

Dëshiroj që të mos ketë më histori të tilla emigrimi dhe më e rëndësishmja uroj që fjala emigracion të zhduket nga fjalori ynë i përditshëm.

A. Dardha
Berat



Kështu mori fund edhe shpresa ime...

Varfëria më detyroi të emigroja jashtë vendit. Si rrjedhim mora rrugët e Perëndimit me merakun pas, duke menduar për rreziqet që më prisnin gjatë rrugës dhe me shpresën për të siguruar ndonjë të ardhur.

U nisa me gomone nga Vlora për në Itali, E mora përsipër këtë rrugë, edhe pse e dija se ishte fare e pasigurt. Në Itali më priti një shok, i cili më kishte premtuar më parë se do të më gjente punë. Por me të mbërritur aty, ai më tha se vështirë të gjeje punë në atë kohë në Itali, prandaj do të më çonte në Angli. I mbetur keq në këto rrethana, e pranova ofertën që më bëri i njohuri im.

I hipëm një makine për të shkuar në Francë. Sapo mbërritëm në Francë, shoku im që kishte dokumente të rregullta nga shteti italian dhe mund të lëvizte lirisht, më tha të rrija i fshehur në një vend ku do të vinte të më merrte pas disa orësh. Por më gënjeu, nuk erdhi më, dhe unë mbeta në mes të rrugës. Në këto kushte, dola të kërkoja punë. Fati e solli që krejt rastësisht të takoja një shqiptar teksa po vërdallisesha rrugëve. E pyeta si mund të kaloja nga Franca për në Angli. Por mbeta i shtangur në vend kur ai më tha: “Këtu jemi në Gjenevë të Zvicrës e jo në Francë”. Ai më ofroi “ndihmën” e tij që të gjeja punë, në mënyrë që të siguroja të paktën bukën e gojës. Ky shqiptar më futi pa e kuptuar në trafikun e drogës.

Këtu mori fund edhe shpresa ime për një jetë më të mirë, sepse s’ e pata të gjatë. Më kapi policia dhe kalova një periudhë kohe në burg. Edhe pse kushtet e atjeshme ishin normale dhe trajtimi i mirë, prapëseprapë burgu burg mbetet.

G. Doko
Berat

Dua të jetoj si gjithë të tjerët



Më 1 Shkurt 1999 hyra në Zvicër dhe u regjistrova në azil për tre muaj. Kërkova punë gjatë gjithë kohës që qëndrova në azil, por nuk më ndihmoi askush, pasi nuk kisha të drejtë për të punuar. Aty na trajtonin mirë, na ndihmonin kur kishim nevojë për rroba, ushqim, cigare.

Më pas më dhanë negativin që të largohesha nga Zvicra, por unë nuk kisha pará që të largohesha. Për të fituar parátë e biletës shita 5 gr. drogë, por më kapi policia dhe u dënova disa ditë. Më pas më kthyen në Shqipëri.

Në vitin 2000 tentova të shkoja në Gjermani nga Zvicra, por më kapi policia zvicerane dhe u dënova prapë, këtë herë me tre muaj burg. Pas kësaj më kthyen në Shqipëri.

I pakënaqur nga dy emigrimet e mëparshme, më 2001 shkova sërish në Zvicër, edhe këtë herë me mendimin për të kaluar në Gjermani. Por nuk më mjaftuan parátë për të arritur në destinacion dhe u detyrova të shisja drogën e një kosovari, për të fituar aq sa mund të blija një biletë treni për në Gjermani. Përsëri më ndaluan dhe më dhanë si dënim 15 muaj burg.

U lirova në Tetor 2002. Tani jam këtu, në vendin tim dhe kam filluar të punoj që të marr një profesion dhe të jetoj si gjithë të tjerët.

D. Maliqi
Berat



Isha i padëshiruar, sepse isha shqiptar


Të emigroje në moshën time nuk ishte e lehtë, por hallet e shtëpisë, vuajtjet dhe varfëria më detyruan edhe mua si shumë të tjerë të përplasja kokën në emigrim, atje ku mendoja se çdo gjë do të ishte ndryshe. Por nuk ishte ashtu. Vuajtjet, hallet dhe problemet që kisha provuar në Shqipëri më ndoqën edhe në vendin ku mendoja dhe shpresoja të zgjidhja hallet e mia.

Vajtja në Itali ishte e vështirë, por akoma më e vështirë ishte se nuk kisha një njeri të më ndihmonte me sado pak të ishte e mundur. U gjenda mes katër rrugëve pa asnjë shpresë. U mendova gjatë dhe vendosa të shkoja në vendin për të cilin më kishte folur një shok. Kështu lashë Italinë, pasi nuk kisha shpresë për punë dhe u nisa drejt Zvicrës, ku arrita jo pa vështirësi. Por edhe atje nuk më buzëqeshi fati, pasi u kapa nga policia dhe nuk pata kohë as të futesha në kamp e të regjistrohesh si azilkërkues. Isha i padëshiruar, sepse isha shqiptar.

Pasi kreuva dënimin, më kthyen në Shqipëri. Isha i mërzitur dhe i ngarkuar me më shumë halle se më parë.

L. Ndrevataj
Mamurras

Çdo azilant ka shumë për të treguar



Në emigrim, çdonjeri ka historinë e tij të jetës, të punës apo diçka tjetër, që shënohet që nga dita e parë e regjistrimit në azil e deri në përfundimin e tij. Kam mendimin se çdo azilant ka se çfarë të shkruajë për qëndrimin e tij atje dhe për trajtimin që i bëhet nga autoritetet e shtetit pritës. Shkurtimisht unë do të doja të shkruaja historinë time të emigrimit në shtetin e Zvicrës si dhe disa detaje lidhur me trajtimin tim në këtë shtet.

Pas hapjes së kufirit Shqipëri-Jugosllavi, domethënë pas vitit 1991, u riktheva në vendlindjen e babait tim, në Vuthaj (Komuna e Plavës, në Malin e Zi). Atje kërkova të drejtën e qëndrimit, pasi paraqita të gjitha dokumentet e nevojshme.

Në vitin 1997 më dorëzuan tek organet policore malazeze dhe më akuzuan për trafik armësh për të furnizuar UÇK-në në Kosovë. Kështu qëndrimi im atje u bë i pamundur, pasi rrezikoja një burgim shumë të gjatë, me pasoja të tjera të rënda për mua dhe për familjen time.

Kështu vendosa të emigroja në Zvicër ku qëndrova nëntë muaj dhe më pas u detyrova të largohesha prej andej, pasi rregullat dhe ligjet e Zvicrës veprojnë ashpërsisht, sidomos me ne shqiptarët. Gjatë kësaj kohe u arrestova nga organet e policisë me pretekstin e trafikut të drogës.

Për mua janë të papranueshme, të paargumentueshme dhe mesjetare format që ndjekin organet atje në hetimin e kësaj çështje. Mënyra e hetimit të çon deri atje sa të përkufizon si fajtor dhe që do të përgjigjesh para ligjit. Për mendimin tim, në Zvicër vendos policia dhe jo drejtësia, pasi policia është mbi çdo ligj dhe gjykata dhe prokuroria janë nën urdhrat e tyre. Të drejtën për ta fituar kërkesën për azil thuhet se e japin organet sociale të shtetit, por në realitet e jep policia. Po të hapeshin dosjet e shqiptarëve në Kantonin e Tiçinos, unë jam i bindur se mund të gjenden shumë parregullësi dhe dënime të padrejta.

Mendoj se këto radhë ishin të mjaftueshme për të përshkruar historinë time.

F. Isufi
Fier



Isha i pashpresë

Historia ime në Zvicër filloi vitin e kaluar kur unë bashkë me një shok u nisëm drejt tokës së ëndërruar pas një qëndrimi prej dy muajsh në Itali. Një shok i yni që ndodhej në Gjenevë na siguroi se do të na ndihmonte dhe ne shkuaq atje. Kufirin e kaluaq në Kiaso, pastaj morëm një taksi dhe më tej udhëtuam me tren.

Me të vajtur në Gjenevë, u përfshimë në rrjetin e një grupi shpërndarësish droge. Unë nuk e kisha ditur më parë se edhe shoku im ishte pjesë e këtij rrjeti. Për një periudhë kohe bëmë këtë punë, por nuk zgjati shumë, sepse të dy përfunduaq në polici e më pas në burgun e Shandelonit të Gjenevës. Bëmë disa muaj burg dhe më pas na riatdhesuaq.

Por unë nuk u dekurajova dhe vajta sërish në Zvicër. Shkak për këtë ishte njohja që pata me një vajzë zvicerane vitin e kaluar. Marrëdhëniet me këtë vajzë nuk i kisha ndërprerë edhe gjatë kohës së burgimit. Kështu që vendosa të shkoja sërish në Gjenevë të takoja të dashurën time. Bashkëjetoja me të dhe ndërkohë bëja përpjekje të merrja leje qëndrimi.

Në fillim të gushtit më arrestuaq në Bernë bashkë me të dashurën time, sepse isha pa dokumente. Më futën në burg ku qëndrova afro një muaj e gjysmë dhe pastaj më kthyen. Isha i pashpresë...

G. Llangozi
Berat

Kurrë më emigram!



U nisa nga Tirana për në Vlorë më 14 Qershor. Kisha një shok në Zvicër, i cili ma mbushi mendjen që të shkoja edhe unë atje. Gjeta një person që merrej me këto punë dhe pas njëfarë kohe u nisa.

Në Vlorë fjeta një natë në një motel buzë detit dhe të nesërmen rreth orës 10 e 30 të mbrëmjes u nisëm me gomone për në Itali. Gomonia u mbush plot, madje kishte mbingarkesë. Mbas rreth 3 orësh iu afruam bregut dhe drejtuesit e gomones na urdhëruan që të hidheshim në det që të mos diktoheshim. Me zor çava deri në breg për shkak të çantës me plaçka që kisha marrë me vete. Kur dolëm, shoqëruesi na mbloodhi të treve dhe na tha se duhej të iknim me vrap që të mos na kapnin. Ecëm si të marrë, derisa dolëm buzë një autostrade ku na priste një kamion. Pas 30 minutash arritëm në një kapanon prej dërrase ku do të kalonim natën. Aty me siguri duhej të kishin mbajtur kafshë, pasi binte erë shumë të keqe, megjithatë ishim aq të lodhur sa s'na bënte më asgjë përshtypje.

Të nesërmen në mëngjes na solli diçka për të ngrënë dhe na tha se pas pak do të niseshim. Para se të hipnim përsëri në kamion na dha ca pako biskota për t'i ngrënë rrugës. Udhëtuam gjatë gjithë ditës dhe në darkë vonë kamioni ndaloi; na thanë se duhej ta kalonim kufirin më këmbë. Ecëm për rreth 1 orë e gjysmë, derisa dolëm në një vend buzë rrugës ku kishte disa taksi. Shoqëruesi na tha se do merrnim taksi deri në Lugano dhe pastaj trenin për në Bernë.

Me të arritur në destinacion na thanë që të lajmëronim njerëzit e shtëpisë, që të paguanin pjesën tjetër të parave. Më pas të gjithë u shpërndamë në drejtime të ndryshme. Unë i telefonova shokut tim në Bernë dhe i thashë të vinte të më merrte te stacioni i trenit. Isha tmerrësisht i lodhur dhe fjeta gjithë ditën.

Të nesërmen dolëm të punonim. Gjatë periudhës që ndenja atje punova si shumë shqiptarë të tjerë. Një mbrëmje, ndërsa po flisja në telefon me njerëzit e shtëpisë, erdhi një polic dhe më kërkoi dokumentet. Më morën me vete dhe më çuan në një burg minorenësh në Witswill. Atje



u njoha me shumë shqiptarë të tjerë. Ndenja aty vetëm dhjetë ditë, pastaj me ndihmën e një shoku gjeta një biletë avioni për t'u kthyer në Shqipëri.

U ktheva dhe tani po mundohem që të marr ndonjë zanat, sepse nuk dua që të shkoj më në emigrim. Kjo ishte gjithë historia ime. Edhe pse tani jam në këtë vend të varfër, ndihem shumë herë më mirë se në Zvicrën e pasur.

S. Ludi
Tiranë

Të punojmë që ta ndërtojmë Shqipërinë...



Unë që po ju tregoj këtë histori quhem Nikollë. Emigrimin e fillova qysh në vitin 1991. Asokohe jetoja në Tropojë. Në fillim u shpërngula në Kosovë. Por, duke parë që nga Serbia nuk mund të kaloja për në perëndim, vendosa të punoja në Greqi.

Andej kishte shumë probleme për shqiptarët, duhej të flije jashtë, paga ishte shumë e vogël, po të të kapte policia të keqtrajtonte brutalisht dhe më pas të kthente mbrapsht. Por unë munda të rezistoj në këto kushte për pesë vjet, nga Korriku 1991 deri në Dhjetor 1996. Pikërisht në dhjetor të vitit '96 u ktheva në Shqipëri e që andej vendosa të nisesha drejt perëndimit.

Ishte dimër i ftohtë kallkan. Pritëm me ditë të tëra në Vlorë, në një bodrum. Më në fund erdhi ora që do të na nisnin. Më kujtohet që në gomone kishte shumë gra me fëmijë të vegjël, të cilat shkonin për t'u bashkuar me bashkëshortët e tyre në Itali. Atë natë nuk do ta harroj kurrë, por nuk dua të shkruaj më gjatë se ishte tmerr i gjallë.

Me të mbërritur në Itali, kujtova që për mua u hap një dritë jeshile. Pasi u solla rrugëve shumë ditë pa punë, takova një të njohur që më mori në Romë. Më gjeti një punë për të prerë, sistemuar dhe ngarkuar drutë në mal. Por ishte punë shumë e rëndë, ushqimi i keq dhe paga e ulët. I pakënaqur vendosa të largohesha nga Italia drejt një shteti tjetër.

Me ndihmën e dy shokëve shqiptarë arrita në Zvicër dhe u regjistrova si kosovar nga Gjakova. Fakti që kisha qenë më parë në Gjakovë më ndihmoi që t'iu përgjigjesha pyetjeve që më drejtuan. Atje takova shumë shqiptarë të tjerë. Punë të pastër nuk kishte, sepse unë nuk kisha letrat e punës. U detyrova të përfshihesha në tregtinë e drogës. Fitimet ishin të mëdha, por e gjithë kjo nuk zgjati shumë. Më kapi policia dhe u dënova me dy vjet burg.

Kur jeton në Shqipëri, të duket se kurbeti është gjëja më e mirë. Vetëm kur e provon, e sheh se si është në të vërtetë. Kur kthehesh, përsëri thua me vete: Në Shqipëri nuk jetohet. Por në fakt këtu kemi lindur dhe këtu do të jetojmë ose do të kthehemi një ditë. Prandaj le t'ia dhurojmë Shqipërisë fuqinë e idetë tona, më mirë se sa të na i shfrytëzojnë të tjerët.

Nikollë Zh.
Tropojë



Aty ku kam zemrën jam i lumtur

Si çdo i ri shqiptar edhe unë mora rrugën e kurbetit për një jetë më të mirë. Dhe një ditë të bukur u nisëm me një shokun tim për në Vlorë, ku na priste gomonia për të kaluar detin. Më pas nga Italia do të hidheshim në Zvicër. Na e kishin bërë shumë të lehtë, por të kalosh detin me gomone është një ferr i vërtetë. Para se të niseshim nga Vlora na bënë të gjithëve fotografi dhe kur i pyetëm se përse duheshin këto foto na u përgjigjën se, në rast kthimi nga policia ose në rast aksidenti në det, u duheshin për të identifikuar personat.

U nisëm dhe bëmë një udhëtim rreth dy orë në det. Kur po i afroheshim bregut, na thanë të hidheshim me not. Te bregu i detit na priste një shoqëruar, i cili na futi në pyll ku ecëm me rroba të lagura në trup për më shumë se një orë deri në një rrugë automobilistike. Pastaj erdhi një furgon mallrash dhe aty na rrasën të gjithëve. Na çuan deri në Bari dhe më pas na lanë në mëshirë të fatit.

Pas shumë peripecish për të arritur kufirin zviceran, së bashku me shokun tim kaluam në Lucernë. Shëtitem gjatë gjithë ditës nëpër qytet për të takuar ndonjë shqiptar, i cili mund të na adresonte për në kampet e refugjatëve. Rastësisht takova njërin, që më tregoi ku rrinin disa bashkëshatarë të mi. Ata na strehuan në hotelin ku rrinin vetë dhe na premtuan se do të na gjenin punë, madje do të mund të fitonim mirë.

Qëndrova pesë ditë aty. Gjatë kësaj kohe dilja dhe shëtisja për të parë qytetin, derisa një ditë erdhi policia dhe na mori të gjithëve, ashtu në gjumë siç ishim. Në polici mora vesh se na akuzonin për shpërndarje droge. Gjatë ditëve në vazhdim më morën në pyetje dhe më thonin të pranoja se merresha me drogë dhe isha bashkëpunëtor me ta.

Me gjithë këmbënguljen time për pafajësi, ata më nxorën në gjyq dhe më dënuan me 3 vjet burg. Unë kërkova përsëri pafajësi, por kush më dëgjonte. Edhe avokati ishte në anën e tyre. Unë nuk kisha para të paguaja, kështu që u dënova duke qenë i pafajshëm.

Po vazhdova të tregoj për ditët e burgut, s' do të mbaroj kurrë. Dihet se çdo shqiptar në çdo vend të botës trajtohet më keq se çdo emigrant tjetër, sepse qeveria jonë, shteti ynë nuk mban përgjegjësi për shtetasit e vet. Me këtë rast dua t'i them gjithë rinisë shqiptare që lumturinë dhe rehatinë ta kërkojmë në vendin e tyre dhe të mos bëhen leckë e të tjerëve.

L. Mici
Tropojë





Histori të tilla në Evropë u ndodhin vetëm shqiptarëve

Ka kaluar disa kohë, por mua vazhdon të më mbetet në kokë udhëtimi im për në Zvicër. Ju siguroj që nuk është e lehtë të bësh një rrugë të tillë e për më tepër në një natë janari. Në fund të vitit 2000 u kthye nga Zvicra kushëriri im Bledi. Ai kishte gati një vit e gjysmë që rrinte atje. Pasi u takuam dhe ndenjëm bashkë, ai më propozoi ta provoja njëherë jashtë Shqipërisë. Oferta e tij më joshi dhe unë pranova menjëherë. Të gjitha shpenzimet do t'i merrte ai përsipër.

Më 4 janar u nisëm për në Vlorë. Atje Bledi u takua me dy skafistë. Pasi caktuan orën dhe shumën e parave për nisjen, pushuam në një hotel. Gjithsej ishim 6 vetë që niseshim për në Zvicër. Të gjithë qëndronim në heshtje, asnjërin nuk e zinte gjumi. Me siguri mendonin për familjen, ashtu sikurse bëja edhe unë. Pas orës 12.30 të natës erdhi dikush dhe na tha të bëheshim gati se do të niseshim. Nga ora dy e natës më në fund u nisëm. Skafi ishte plot. Rreth 30-40 veta ishin bërë njësh me njëri-tjetrin. Në skaf kishte fëmijë, djem të rinj dhe vajza të reja, fati i të cilëve s'dihej ku ishte. Shikoja dallgët e detit, që të futnin tmerrin. Kishte raste kur skafi tronditej aq shumë, sa të gjithë bërtisnim. Bënte shumë ftohtë, megjithëse ishim veshur trashë. Uji ishte akull. Këtë e ndienim tek pikat që na binin në fytyrë gjatë përplasjes së skafit me dallgët. Nuk mund t'i heq nga mendja çastet e tmerrit kur një bashkudhëtar i imi, ngaqë nuk u mbajt dot apo ndoshta ishte sëmurë, ra dhe e përpiu deti.

Në Zvicër jam marrë me drogë. U strehuam në një shtëpi të vogël njëkatëshe afër Bernës, pronë e një gruaje të moshuar. Shtëpia ndodhej në periferi dhe kishte poshtë një bodrum ku paketonim mallin.

Në përgjithësi lëviznim natën, sepse ditën kishte shumë policë nëpër rrugë. Piacat ishin vendi ku mblidheshim dhe tregtonim mallin. Zakonisht klientët vinin me makina dhe sinjali për të marrë mallin ishin fikja dhe nderja e dritave. Pak syresh vinin më këmbë. Zakonisht shisnim edhe nëpër diskoteka. Rrëmuja na ndihmonte që të shpërndanim më shumë dhe pa rënë në sy. Kishim një bashkëpunëtor zviceran që e quanim Xhei. Ai fliste shumë mirë shqip. Ai na ndihmonte, pasi e njihnte mirë terrenin dhe mallin, të cilin e përdorte edhe vetë rregullisht. Punët na

shkonin shumë mirë, deri kur Xhejin e kapën me mall. Për ne tashmë ishte e qartë se pas tij do të na vinte radha neve, kështu që vendosëm të ktheheshim në Shqipëri. Njëri prej nesh pati gjithashtu disa probleme familjare, kështu që u detyruam të shpejtonim. Kthimi ishte më i lehtë se vajtja, sepse policia italiane nuk na nxori asnjë lloj problemi.

Duhet të them se nuk jam krenar për këtë që kam bërë. Besoj që u kthyem për të mos shkuar më, ndoshta kurrë.

R. Boriçi
Tiranë





Jam e lumtur që u ktheva

Të detyruar nga kushtet e vështira ekonomike, vendosëm të largoheshim nga Shqipëria drejt rrugëve të Evropës. Ishte e enjte, 25 Korrik, kur vendosëm të braktisnim gjithçka në Shqipëri me shpresën se do të fillonim një jetë më të mirë në dhé të huaj. Në orën 8 të mbrëmjes bashkë me prindërit dhe vëllain si dhe disa shqiptarë të tjerë hipëm në gomone dhe u nisëm. Çasti i shumëpritur kishte ardhur, dhe ne u nisëm pa e ditur se ç'na priste më pas.

Udhëtimi me gomone ishte një ferr i vërtetë. Ndodheshim në mes të detit të ndriçuar vetëm nga drita e zbehtë e hënës. E papritura mund të ndodhte nga çasti në çast e ne mund të përfundonim në fund të detit. Por arritëm ta kalonim atë ferr dhe të preknim tokën italiane.

Udhëtua edhe dy ditë të tjera me një tren mallrash për të mbërritur në Zvicër. Menduam se të keqen e lamë pas, por në të vërtetë nga shiu ramë në breshër. Përfunduam në Gjenevë. Aty u regjistruam në kampin e refugjatëve, përveç babait, i cili u strehua te një shoku i tij, që i kishte premtuar t'i gjente një punë. Në atë kamp kishte refugjatë nga vende të ndryshme të botës, të cilët po ashtu si edhe ne, nuk kishin asnjë shpresë se jeta mund të ndryshonte në vendin e tyre.

Pas disa ditësh na vaksinuan. Nuk e di pse, por ndoshta kishin frikë se ne të varfërit ishim burim sëmundjesh. Ndenjëm aty afërsisht tre muaj. U dogjëm nga malli për të dëgjuar pak shqip. Ditë të çmendura, net plot ëndrra, lotët nuk thaheshin në faqet tona. Duke parë se dita që vinte ishte më e rëndë se ajo që kishim lënë pas, vendosëm të ktheheshim nga kishim ardhur. Për mua ishte një rilindje.

U nisëm nga Gjeneva dhe mbërritëm në Tiranë. Brenda ditës arritëm në Lushnje. Më kishte marrë malli për gjithçka. Nuk do të arrija kurrë të përshkruaja dhimbjen dhe vuajtjet e atij udhëtimi. Megjithëse roj ende në kushte të vështira, jam e lumtur që u ktheva.

Histori pa emër autori

Fjalët nuk mjaftojnë për ta përshkruar



Ishte muaji Shkurt atëherë, kur unë së bashku me të fejuarin morëm rrugën e emigrimit. U nisëm duke menduar se atje ku do të shkonim do të gjenim një të ardhme më të mirë. U nisëm me gomone nga Vlora drejt Italisë. Nuk ishin vetëm, kishte edhe të rinj të tjerë si ne. Frynte erë dhe bënte shumë ftohtë. Nuk do ta harroj në jetë të jetëve atë udhëtim të frikshëm. Ishim nisur drejt së panjohurës dhe ndjenja e ankthit dhe frikës na shoqëronte në çdo hap.

Kur mbërritëm në Itali, na pritën disa miq kosovarë që u patëm dhënë strehë gjatë kohës së luftës në Kosovë. Qëndruam aty rreth një javë. Më pas miqtë kosovarë na ndihmuan që të futeshim në Zvicër.

Atje u regjistruam në kamp. Kishte plot shqiptarë dhe nënshtetas nga vende të tjera. Unë nuk dilja fare nga kampi, ndërsa i fejuari im dilte dhe mendohej të gjente ndonjë punë. Ndodhi shumë shpejt që mora vesh se ishte kapur nga policia zvicerane së bashku me disa shqiptarë të tjerë të përfshirë në trafikun e drogës.

Erdhi ajo që nuk e prisnim: pas tre muajsh e gjysmë na kthyen në Shqipëri, pa menduar për vuajtjet që kishim përjetuar gjatë asaj kohe. Pas kësaj përvoje të hidhur, që më mësoi shumë gjëra, do t'i lutesha shtetit tonë të bënte diçka më shumë për shqiptarët, që të mos shkojnë më në emigrim dhe të punojnë në të zezë, atje ku të shfrytëzojnë si sklllevër në mesjetë.

Hajrije M.
Kukës



Shteti duhet të marrë më shumë përgjegjësi

Gjatë viteve 70-të familja ime ishte shpërngulur nga fshati i lindjes në një fshat tjetër afër Bajram Currit. Kjo lëvizje u bë për arsye ekonomike. Në vitet 90 jetoja në Bajram Curri. Me kalimin e kohës shikoja që kërkesat rriteshin, kushtet e jetesës vështirësoheshin, të ardhurat e mia ishin fare minimale, mundësia për punësim ishin zero. Kështu që u detyrova të merrja rrugën e emigrimit. Kisha lënë në Shqipëri gruan dhe dy fëmijët pa asnjë të ardhur dhe pa asnjë përkrahje.

Ashtu si një pjesë e madhe shqiptarësh, të cilët nuk kanë mundësi të pajisen me viza, udhëtova me gomone për në Itali dhe më pas dy ditë me tren deri në Milano, duke mos patur asnjë njeri që të më ndihmonte. Prej andej eca më këmbë mbi 50 km për të arritur në Kiaso të Zvicrës ku u regjistrova si azilant kosovar. Qëllimi i migrimit ka qenë gjithmonë të punoja, të fitoja të ardhura ndershmerisht dhe t'i dërgoja para familjes.

Gjatë kësaj periudhe u përpoqa të gjeja punë, por ishte e pamundur, vështirësitë shtoheshin nga dita në ditë. Duke parë gjendjen time pa rrugëdalje, u joshja nga ofertat e disa shokëve që nuk i njihja sa duhet dhe u përfshiva në transportin e drogës. Por që në rrugën e parë më kapi policia dhe më arrestoi. Gjykata më dënoi me 24 muaj burg dhe prej tyre unë vuajta 16 muaj. Menjëherë pasi mbarova dënimin, me pak të ardhura që kisha arritur të mbledhja duke punuar në burg, u ktheva në Shqipëri. Kështu ishte shkruar fati im...

Kam vuajtur shumë, prandaj i jam mirënjohës shoqatës tuaj në Tiranë, që më u gjend pranë. Ishte një fat i madh për mua e familjen time, sepse na u krijua mundësia për të mbijetuar. Ju jam mirënjohës për ndihmën tuaj në këtë periudhë të vështirë të jetës tonë, ku shteti nuk do t'ia dijë për fatin e të varfrit.

R. Hasani
Tropojë

Historitë e emigrimit, të dhimbshme si vetë emigrimi



Historia ime besoj se nuk ndryshon shumë nga historitë e shqiptarëve të tjerë. U nisa nga Tirana për në Vlorë. Atje takova disa shokë, të cilët më ndihmuan të kaloja me gomone për në Itali. Gjatë udhëtimit nuk na ndahej anija patrulluese italiane dhe një helikopter. Skafisti nuk pranoi të ndalonte, sepse kishte frikë se i bllokoni gomonen, e cila sipas tij kushtonte 50-100 milion lireta. Dallgët që krijoheshin nga lundrimi i anijes italiane vërshonin mbi ne dhe na mbulonin trupin.

Më në fund iu afruam bregut dhe skafisti na urdhëroi të hidheshim në det. Uji ishte akull i ftohtë dhe thellësia mbi 2 m. Dolëm në breg, ashtu të lagur siç ishim, dhe nisëm të vraponim. Papritur pamë ushtarët italianë, të cilët na urdhëruan të ndalonim, por ne vazhduam të vraponim si të çmendur. Kaluam një autostradë të madhe dhe na dolën përpara disa sera. Ishim të etur, por nuk dinim ku kishte ujë. Ecëm më tej dhe gjetëm një tub të madh, i cili shërbente për vaditje serash. Shpuam tubin për të shuar etjen, por presioni i ujit ishte i madh dhe përmyti serat. Pronari i serave i alarmuar lajmëroi policinë. Ne u larguam menjëherë dhe përfunduam në një kanal të madh ku kaluam dy ditë të zhytur në baltë.

Të mbetur në mes të rrugës menduam të vidhnim një makinë, e cila ishte parkuar shumë afër nesh. E morëm dhe shkuam në Milano, e që andej morëm trenin për në Komo. Në Komo takuam disa shqiptarë, të cilët na thanë se për të kaluar në Kiaso të Zvicrës ishte shumë e vështirë. Megjithatë unë mora guximin dhe me disa shqiptarë të tjerë u nisëm për në Zvicër në këmbë. Kaluam malet e Komos, por papritur na dolën përpara ushtarët zviceranë. Ne ikëm me vrap, por ata na lëshuan qentë dhe na kapën. Më çuan në një burg në Kiaso.

Pas kësaj e provova edhe pesë herë të tjera. Herën e fundit policia e Komos më dha paralajmërimin e fundit për largim nga Italia, por unë nuk u mërzita. Historitë e emigrimit duan një roman të tërë që të shkruhen sepse janë vërtet të dhimbshme, ashtu siç është vetë emigrimi.

Sh. Geci
Tropojë



Itinerari i shtegtimit tim në Evropë

Këtu po përshkruaj shkurt itinerarin e shtegtimit tim në Evropë. Historia ime, edhe pse duket një aventurë, është e gjitha e vërtetë.

U nisa nga Vlora për në Itali, ku qëndrova afërsisht 20 ditë duke fjetur nëpër lulishte dhe stacione trenash. Pastaj shkova nga Italia për në Gjermani me tren mallrash. Shtatë orë m'u desh të udhëtoja në shi dhe kur mbërrita në Mynih, isha bërë kallkan nga të ftohtët. Isha veshur me rroba vere, pasi në Shqipëri bënte vapë. U regjistrova menjëherë si azilant politik, pasi nuk po shihja asnjë mundësi tjetër e po vdisja nga uria dhe nga të ftohtit.

Qëndrova në azil dy muaj. Do të dëshiroja të rrija më shumë, por kërkesa ime për azil politik u refuzua nga organet kompetente. Kështu u detyrova të largohesha nga Gjermania në drejtim të Belgjikës.

Qëndrova në Bruksel dhe u kërkova ndihmë shqiptarëve që jetonin atje, por, kur nuk i njehej njerëzit, askush nuk të ndihmon.

I detyruar nga halli e lashë Belgjikën dhe u nisa për në Francë. Shkova në Paris me shpresën se atje do të ishte ndryshe nga vendet ku kisha qenë më parë. Edhe Parisi nuk më ofroi asgjë më shumë se fqinjët e tij.

Më pas shkova në Amsterdam, Hollandë dhe kërkova azil, por edhe atje m'u refuzua kërkesa. Nga Holanda u nisa për në Zvicër. M'u desh të ecja tri ditë në këmbë. Kur më merre uria, haja panxhar lopësh.

Duke mos i njohur shtigjet ku kaloja, hyra përsëri në tokën gjermane. Kisha ecur për tre ditë rresht rreth të njëjtit mal dhe nuk kisha shkuar asgjëkund. Aty takova një durrsak, i cili më ndihmoi të kaloja në Zvicër. Shkova në Bazel, por nuk u regjistrova në azil nga frika se mos më kthenin përsëri mbrapsht. Nga Bazeli kalova në Kiaso ku jetova në një "kamp përqëndrimi". Kisha vetëm pesë orë liridalje në ditë. Pastaj më kthyen.

R. Kalemaj
Berat

Zoti do të na shohë edhe ne



Është shumë e vështirë të marrësh rrugët e botës, pa ditur se ku do të vesh. Largohesh nga njerëzit më të dashur, nga fëmija, njerëzit e tu të zemrës, për hir të kushteve të vështira të jetesës.

Nisja ishte e tmerrshme: Natë pa hënë, qiell pa yje, klithma frike që shoqëronin atë natë të paharruar për mua. Vdekja ishte fare pranë. Era frynte aq fort, sa dukej se do të na merrte me vete.

Nga Italia kaluam në Zvicër, ku na u duk se çdo gjë ndryshoi. Po kjo s'ishte veçse e përkohshme. Kishim ardhur në një vend të panjohur, dëgjonim një gjuhë të huaj dhe çdo gjë sa vinte e bëhej më e vështirë dhe e padurueshme. Shkuam në Bazel ku ishin disa shokë të burrit që na gjetën një vend sa për të futur kokën.

Që ditën e parë u mbylla në shtëpi, vetëm qaja për djalin tim të vogël, të cilin e lashë te prindërit e mi në Shqipëri. Nuk më largohej nga mendja. Asnjë nuk na ndihmonte, gjendja sa vinte dhe keqësohej. Im shoq filloi të mërzhitej jashtë mase. U detyrua të merrej me punë që të çonin drejt dyerve të burgut. Ditë për ditë i lutesha të dorëzoheshim në polici dhe të ktheheshim te djali që kishim lënë vetëm. Asnjëherë nuk më kthente përgjigje tamam, vetëm më thoshte se Zoti do të na shohë edhe ne dhe do bëjë të jetojmë më mirë. U mundova edhe vetë të gjeja një punë, por as që bëhej fjalë. Ku të trokisja unë kur nuk dija asnjë fjalë? Kështu shpresa se një ditë do të bëhej më mirë filloi të venitej. Tim shoq e kapi policia dhe e futi në burg.

Pas gjashtë muajsh edhe mua më ktheu policia në Shqipëri. Kanë kaluar disa muaj qyshse jam kthyer, por nuk kam asnjë lajm nga burri. Tani rri te prindërit e mi bashkë me fëmijën. Gjendja ime ekonomike është mjaft e rënduar. Shpresoj se shoqata juaj do të më ndihmojë.

Histori pa emër



Jam i lumtur që jetoj akoma

Aventura ime e pafat filloi që kur u nisa nga Vlora me skaf. Na hodhën në det pothuaj një km larg bregut. Mezi arrita të shpëtoja një fëmijë pesëvjeçar që nuk dinte not.

Në Itali ndenja tre muaj, por nuk gjeta dot punë. Gjithë ditës sillsha nga një vend në tjetrin me shpresën e gjetjes së ndonjë pune, por ishte e kotë. E vetmja punë që mund të bëja ishte shpërndarja e drogës. Pothuajse të gjithë emigrantët merreshin me punë të zezë, për të nxjerrë paratë për të vajtur në Zvicër, Francë, Belgjikë, Gjermani, Hollandë, Angli etj.

Jam përpjekur ta kaloj kufirin mbi dhjetë here, por pa sukses. Nuk i shpëtoja dot policisë kufitare zvicerane. Në Kiaso jam regjistruar disa herë. Autoritetet e atjeshme më jepnin një dokument azili për në Milano, por në azil ishte e kotë të qëndroje. Në doganën italiane policët italianë na thoshin: “Hidhuni në Zvicër, se atje ka punë për ju, këtu te ne e keni të kotë”. Madje disa prej tyre shpesh edhe na kanë treguar mënyra se si mund të kalonim kufirin pa u diktuar.

Pas shumë përpjekjesh e tentativash për të kaluar kufirin më në fund arrita të hyja në një qytet të vogël, të cilit nuk ia mësova kurrë emrin. Prej andej vazhdova të ndiqja rrugën përgjatë hekurudhës, duke kaluar në një tunel të ndriçuar dobët. M’u desh të ecja të paktën tri orë. As vetë nuk e di se si arrita të dilja gjallë prej aty. Pas një udhëtimi raskapitës, më në fund arrita të dalloja dritat e Luganos. Ishte tmerrësisht ftohtë dhe nuk dija nga të shkoja. Këmbët nuk i ndieja më, më ishin mpirë. U strehova te kalaja e vjetër e qytetit ku e gdhiva deri në mëngjes nga frika se mos ngrija.

Me shumë mundime më në fund bëra lekët për të blerë një biletë për në Kreuzlingen, ku ishte azili. U regjistrova në Kryqin e Kuq. Pasditeve na lejonin të dilnim. Në qytet kishte edhe një Klub Shqiptar, në të cilin të ofronin ndihmë të çfarëdollojshme. Gjatë kësaj kohë bëra dy intervista. Në të dytën më kthyen përgjigje se nuk më ishte miratuar kërkesa ime

e azilit, dhe më çuan direkt në burg. As vetë s'e kuptova për çfarë më akuzonin. Më bënë gjyqin dhe më komunikuan se po të kapesha përsëri do të dënohesha me gjashtë muaj burg dhe 11.000 franga gjobë. Për tre vjet nuk duhej ta shkelja Zvicrën as edhe me vizë turistike. Nuk e kuptova kurrë se pse më dënuan, ç'kisha bërë për të merituar një dënim të tillë.

Mbas një jave më dërguan në Zyrih. Që aty më nisën me avion për në Shqipëri duke më dhënë edhe 65 USD me vete. Në ato çaste nuk e doja veten. U ktheva përsëri në atdheun plot halle.

Alfons P.
Skrapar





Ne shqiptarët jemi popull i rritur në jetimore

Mërgim është një fjalë, që unë dhe shumë të rinj shqiptarë kur e dëgjojmë, na bën të tronditemi. Të shkosh në emigrim, për shqiptarët do të thotë të shkosh drejt ferrit.

Këtë ferr e provova edhe unë kur u nisa për në Itali në Gusht të '98-ës. Kushtet e motit ishin në disfavorin tim, gjatë 7 ditëve u nisa 4 herë me motoskaf për në Itali dhe vetëm herën e katërt, munda të mbërrija në brigjet italiane. Tre net fjeta jashtë në lulishte, pasi nuk kisha ku të shkoja. Tentova tri herë të kaloja kufirin për në Zvicër dhe të tri herët u ktheva mbrapsht nga forcat kufitare zvicerane. Qëndrova nëntë ditë në Komo duke fjetur në lulishte, duke u ushqyer një herë në ditë në një qendër të Kryqit të Kuq. Pas 9 ditësh tentova për të katërtën herë të kaloja kufirin zviceran dhe më në fund, pas shumë mundimesh, arrita të futesha në Zvicër.

Në fillim u vendosa në Kiaso dhe më pas në Gjenevë. Për një muaj e gjysmë jetova në një ndërtesë prej dërrase, e cila ishte në kushte jo të mira banimi. Nuk kisha të drejtë pune dhe me vështirësi ushqehesha. Pas një muaji e gjysmë filluan ditët e ferrit për mua. Më erdhi ultimatum i që të largohesha nga Zvicra për 24 orë. Kjo sepse isha regjistruar si kosovar, por në të vërtetë isha nga Shqipëria.

U largova nga azili dhe mbeta në mes të katër rrugëve: pa punë, pa shtëpi dhe me policinë që më ndiqte hap pas hapi. Pas disa muajsh përplasje rrugë më rrugë e cep më cep, duke mos pasur asnjë rrugëzgjdhje tjetër, u detyrova t'i hyja asaj rruge të gabuar, e cila dita-ditës po më afronte drejt dverve të burgut.

Që nga Nëntori i '98-ës e deri në Gusht të '99-ës jam keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht nga policia. Më kanë rrahur në mes të rrugës, në sy të gjithë njerëzve. Vetëm nëpër filma kam parë skena të tilla. Që pas asaj nate kam qenë shumë i lënduar fizikisht. Për 10 ditë nuk kam mundur të bëj as edhe një shëtitje në oborrin e burgut. Nga që isha i lënduar edhe në fytyrë, për një muaj nuk më sollën as avokatin. Kishin frikë se mos i denoncoja për keqtrajtme fizike. Të tilla veprime policia nuk mund t'i

bëjë me asnjë shtetas tjetër, përveçse me shqiptarët. Nuk jam i vetmi i lënduar fizikisht e psikologjikisht, histori të tilla kanë ndodhur edhe me shqiptarë të tjerë, të cilët edhe pas një viti burg kanë përfunduar nëpër spitale. Edhe gjatë kryerjes së dënimit me ne shqiptarët sillen ndryshe, na detyrojnë të punojmë aty ku është puna më e vështirë. Po të kundërshtojë, përfundojë dy ditë në izolim.

Unë kisha shpresuar që edhe ne shqiptarët të kishim të drejta njerëzore si të gjithë popujt e tjerë dhe një qeveri që të interesohej për ne. Guxoj të them se jemi popull i rritur në jetimore. Ju uroj gjithë shqiptarëve që të mos kenë një fat të tillë dhe të mos harrojnë thënien e vjetër “Guri i rëndë peshon në vend të vet”.

Xh. Mula
Tropojë





Ku e kemi të ardhmen?

Të emigrosh do të thotë të vuash, të kapërcesh shumë vështirësi që të hedhin përpara dallgët e jetës. Por emigrimi ka brenda edhe pak gaz e shpresë, sepse mendon se do të ndryshosh diçka nga jeta jote, do të fitosh ca para më shumë, pra do ta përmirësosh jetën tënde dhe të familjes.

Më çuan në burgun e Bazelit ku kishte të burgosur nga të gjitha vendet e botës, sidomos kinezë. Shqiptarë ishim gjithsej njëmbëdhjetë. Burgu ishte si mos më keq. Në çdo cep të tij kishte shkrime në të gjitha gjuhët e botës, madje edhe në shqip. Një djalë nga Vlora kishte bërë një poezi për nënën e vet. Të bënte për të qarë. Një tjetër kishte shkruar: “Lus të dal i gjallë prej këtej”. U mërzita aq shumë aty, sa fillova të bëja si i marrë. Fillova të shkruaja edhe unë nëpër ato copëza muri që kishin mbetur bosh. Shihja nga dritarja që jashtë kishte jetë, që njerëzit lëviznin të lirë dhe trishtimi më kaplonte të tërin. Kalonin ditë dhe javë dhe unë përsëri aty. Këto ishin sigurisht ditët më të vështira të jetës sime. Krishtlindjet dhe Vitin e Ri i kalova brenda hekurave të ftohtë të burgut në vend të ngrohtësisë familjare. Më në fund, në një ditë qershori më thirrën për të më kthyer në atdhe. Pas tre orësh udhëtimi me avion isha në Shqipëri. Këtu përfundoi aventura ime zvicerane.

Sa herë më vjen rasti ta përmend këtë histori, më kap një trishtim i madh. Bëra shumë përpjekje ta ndryshoja jetën time, por si shpërblim nuk mora asgjë. Tani them gjithnjë: “Më mirë të jetoj duke lypur në Shqipëri, se të përfundoj si qen birucave të Zvicrës a kujt do vendi tjetër goftë”.

Në emigrim mund të ndërtosh diçka, por mund edhe të humbësh gjithçka. Çdo brez në Shqipëri, me të drejtë, ka ankesa për jetën. Shqiptari historikisht ka vuajtur, por me plot bindje unë ju them se ky brezi ynë është më i vuajturi i të vuajturve, sepse ka përjetuar shumë gjëra të tmerrshme dhe prapë i drejtojmë pyetjen e madhe vetes: Ku e kemi të ardhmen?

K. Smajli
Pukë